



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 155

Tiranë – E martë, 21 korrik 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 15.7.2026	Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” 16121
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 16, datë 8.7.2026	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar..... 16159
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 365, datë 16.7.2026	Për delegim kompetence..... 16160
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 721, datë 13.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 16160
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 722, datë 13.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë..... 16163
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 723, datë 13.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës..... 16165
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 21.5.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2079 (314), datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 16166
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 18.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-651, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë..... 16180

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 80, datë 30.6.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 3664, datë 13.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1833 (67), datë 4.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	16188
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 3180, datë 11.6.2026	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Mark Pematì.....	16196

**VENDIM****Nr. 561, datë 15.7.2026****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E
DHËNIES SË LICENCAVE
PROFESIONALE PËR INDIVIDË DHE
PERSONA JURIDIKË NË FUSHËN E
STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË
NDËRTIM DHE TË MBIKËQYRJES E
KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË
ZBATIMIT NË NDËRTIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 759, datë 12.11.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike, që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Komisioni i Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

RREGULLORE

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E
DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE
PËR INDIVIDË DHE PERSONA JURIDIKË
NË FUSHËN E STUDIMIT E TË
PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE
MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË
PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM**

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti**

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave, të kriterëve dhe të procedurave për dhënien e licencave profesionale për individët e personat juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, si dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Neni 2**Fusha e zbatimit**

1. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo individ apo person juridik, vendas ose të huaj, që ushtron veprimtarinë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, si dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë individët e personat juridikë, vendas ose të huaj, të cilët kërkojnë të pajisen me licencë profesionale apo të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, si dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Neni 3**Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Komision”, struktura e posaçme administrative, që funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtim, që ka autoritetin e vetëm për dhënien apo marrjen e masave administrative, në bazë të kësaj rregulloreje, për subjektet që ushtrojnë veprimtari, në fushën e studimit e të projektimit dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit;



2. “Licencë profesionale”, akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë profesionalisht veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, ose të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim;

3. “Eksperiencë profesionale”, periudha e ushtrimit të aktivitetit profesional në fushat përkatëse, e dokumentuar me referenca apo dokumente ekuivalente, të lëshuara nga persona juridikë publikë apo privatë, apo persona fizikë, nga momenti i diplomimit në nivelet e përcaktuara, në kriteret specifike të kësaj rregulloreje;

4. “Kategori”, specifikimi i llojit apo i nënlojit të veprimtarisë, në fushën e studimit e të projektimit, të mbikëqyrjes e kolaudimit;

5. “Subjekt”, çdo individ, person fizik ose juridik, i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit, të mbikëqyrjes e kolaudimit;

6. “Sekretariati teknik i komisionit”, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, e cila mbështet Komisionin për kryerjen e procedurave administrative, me qëllim trajtimin, vlerësimin, relatin, marrjen e vendimeve, si dhe regjistrimin e individëve dhe të personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e studimit e të projektimit dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit;

7. “Sistemi informatik për licencim, studim, projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të ndërtimit” (në vijim, Sistemi), baza e të dhënave shtetërore për të gjitha aplikimet për licencim në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim, si dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, e cila realizon ndërveprimin e subjekteve të përfshira në këtë proces, duke përfshirë aplikuesin, strukturën përgjegjëse për administrimin e procesit dhe ato institucione publike, që japin informacion lidhur me dokumentacionin e aplikimit.

KREU II

FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE, KOMISIONI I POSAÇËM PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

Neni 4

Krijimi dhe përbërja e Komisionit

1. Komisioni, si strukturë e posaçme administrative, ka autoritetin e vetëm për dhënie,

ndryshimin apo shfuqizimin e licencave profesionale individuale apo të subjekteve juridike, si dhe marrjen e masave administrative për veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe kanë përbërje, si më poshtë:

a) një përfaqësues nga Kryeministria, i cili është kryetar;

b) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ndërtimin;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për energjinë;

ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;

d) një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës;

dh) një përfaqësues nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i Universitetit Politeknik të Tiranës;

e) një përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë;

ë) një përfaqësues nga Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë;

f) një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

g) një përfaqësues nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

2. Anëtarët e Komisionit shpërblehen për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në Komision, sipas akteve nënligjore në fuqi, që përcaktojnë masën e shpërblimit për anëtarët e këshillave, të bordeve apo komisioneve në njësitë e qeverisjes qendrore.

3. Detyrën e sekretariatit teknik të Komisionit e ushtron sektori përkatës për licencimin pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtimin.

Neni 5

Funksionimi i Komisionit

1. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret, të cilat ndërlidhen me objektin e kësaj rregulloreje dhe me kompetencat e komisionit.

2. Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari i tij. Si rregull, ai mbledhet një herë në muaj, si dhe sa herë vlerësohet e nevojshme nga kryetari.

3. Në mbledhjen e tij të parë, Komisioni zgjedh nënkryetarin e tij.



4. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në mungesë të Kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari i Komisionit.

5. Në mbledhje, Komisioni shqyrton e vendos për aplikimet, ankesat, informacionet e paraqitura nga sekretariati teknik, të cilat janë depozituar, të paktën 1 (një) ditë para datës së mbledhjes.

6. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe për to mbahet procesverbal. Procesverbali mbahet nga një përfaqësues i sekretariatit teknik të Komisionit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, pjesëmarrës në mbledhje deri në mbledhjen e radhës.

Neni 6

Funksionimi i sekretariatit teknik

1. Sekretariati teknik organizohet e funksionon pranë drejtorisë përgjegjëse për licencimin, në ministrinë përgjegjëse për ndërtimin.

2. Organizimi i sekretariatit bëhet në bazë të strukturës organizative të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin dhe veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të ministrisë dhe këtë rregullore.

3. Sekretariati teknik ndjek procedurat administrative përkatëse dhe i përcjell Komisionit për shqyrtim materialet, që kanë të bëjnë me licencimin e individëve apo të shoqërive, ankesa të tyre për vendimet pararendëse, informacione e aplikime të personave juridikë publikë apo privatë, përfundime dhe raporte nga kontrollet e kryera.

4. Materialet e përgatitura nga sekretariati, që do të shqyrtohen në mbledhje, u shpërndahen anëtarëve të Komisionit nga sekretariati teknik, jo më vonë se 1 (një) ditë para datës së caktuar për mbledhje.

Neni 7

Dorëzimi dhe pranimi i aplikimeve

1. Aplikimi për licencë, sipas kësaj rregulloreje, kryhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, duhet të jenë:

- a) origjinale ose kopje e njësuar me origjinalin;
- b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre, si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Dokumentet, të cilat ngarkohen nga aplikuesi në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, duhet të ngarkohen të skanuara nga origjinali ose kopje të njësuara me origjinalin.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë sekretariatit teknik kryhet vetëm në këto raste:

a) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë rregullore, për licencat e miratuara para datës 1 maj 2022;

b) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/dokumenteve nga sekretariati teknik;

c) Kur kërkohet verifikim nga Komisioni.

5. Çdo dokumentacion aplikimi apo plotësim i tij shqyrtohet brenda 5 (pesë) ditëve punë, nëse përmban ose jo të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës, sipas kësaj rregulloreje, duke njoftuar aplikuesin, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.

Neni 8

Verifikimi i dokumentacionit dhe plotësimi i mangësive

1. Verifikimi i deklarimeve apo i dokumenteve të subjekteve aplikuese kryhet në bazë të informacioneve, që disponohen nga subjekte juridike publike apo private, pranë institucioneve kompetente.

2. Në rastet kur procedura e verifikimit të dokumentacionit dhe deklarimeve nga subjektet aplikuese tejkalon afatet e trajtimit të aplikimit të përcaktuara në këtë vendim, afatet shtyhen, bazuar në vendimmarrjen e Komisionit, deri në përfundim të procedurës së verifikimit.

3. Në rastet e konstatimit të deklarimeve apo të dokumenteve të rreme, sekretariati teknik e relaton këtë fakt pranë Komisionit dhe Komisioni merr vendim, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 42, shoqëruar edhe me kallëzim në organet kompetente.

4. Kur aplikimi ka mangësi apo nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës, sipas kësaj rregulloreje, sekretariati teknik, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga bërja e aplikimit, njofton aplikuesin,



nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” për plotësimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë. Nëse mangësitë dhe dokumentacioni plotësohen brenda afatit të përcaktuar dhe konstatohen nga sekretariati teknik se këto plotësime janë shteruese, afatet e shqyrtimit të aplikimit konsiderohen që nga momenti i bërjes së aplikimit për herë të parë. Në rast se mangësitë e konstatuara nuk plotësohen brenda afatit të përcaktuar, aplikimi i kthehet aplikuesit nëpërmjet sistemit të licencave.

Neni 9

Marrja dhe hartimi i vendimeve

1. Vendimet në Komision, si rregull, merren me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet, vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve, që marrin pjesë në mbledhje.

2. Vendimet e Komisionit hartohen nën përgjegjësinë e sekretariatit teknik dhe nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit, që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

3. Vendimet e Komisionit dorëzohen në zyrën e arkiv-protokollit të ministrisë.

4. Komisioni merr vendim jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë pune nga momenti i bërjes së aplikimit.

Neni 10

Ruajtja dhe arkivimi

1. Licencat përgatiten/gjenerohen në sistemin elektronik të licencave me të dhënat e hedhura nga sekretariati teknik, bazuar në vendimet e Komisionit, duke marrë vulën elektronike të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, si dhe firmosen me firmën elektronike nga kryetari i komisionit dhe i dërgohen kërkuarit në llogarinë e tij në portalin “e-Albania”.

2. Sekretariati teknik arkivon, sipas rregullave në fuqi, vendimin e Komisionit, licencat e nënshkruara dhe procesverbalet përkatëse. Arkivimi i këtij dokumentacioni organizohet sipas rregullave të brendshme të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, në ambient të veçantë.

3. Dokumentacioni shoqëruar i aplikimeve, i cili ngarkohet nga aplikuesi në portalin unik qeveritar “e-Albania”, apo që gjenerohet nga ndërveprimi i sistemit, arkivohet elektronikisht po në portalin unik qeveritar “e-Albania”.

Neni 11

Bashkëpunimi me persona juridikë publikë apo privatë

1. Sekretariati teknik, nëpërmjet strukturës organizative të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, mban lidhje të qëndrueshme me institucionet e administratës shtetërore. Sekretariati teknik:

a) kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij;

b) trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave apo propozimeve të tyre;

c) kërkon, me shkresë zyrtare, verifikimin e saktësisë së vetëdeklarimeve të aplikuesve apo të vërtetësisë së dokumenteve të lëshuara nga institucionet e të paraqitura nga subjektet në procedurat e aplikimit.

2. Sekretariati teknik ka për detyrë të informojë çdo subjekt aplikues, në lidhje me:

a) kriteret/kushtet e përgjithshme dhe specifike, që nevojiten për të aplikuar për licencë;

b) përputhshmërinë e dokumentacionit, në lidhje me kushtet/kriteret e kësaj rregulloreje;

c) ecurinë e aplikimit të tij për licencë;

ç) të dhëna në lidhje me individë/persona fizikë apo shoqëri të licencuara, për rastet kur aplikuesi vërteton se është i përfshirë në procese ligjore me subjektin, për të cilin kërkon informacion, por pa i vendosur në dispozicion licencën përkatëse apo të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.

3. Sekretariati teknik, sipas kërkesës së Komisionit, apo procesit të përzgjedhjes së verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve/ dokumenteve, kërkon, me shkresë zyrtare, pranë subjekteve private, informacione, në lidhje me vërtetësinë e:

a) referencave të lëshuara nga subjekti privat, të paraqitura nga aplikuesi;

b) projekteve të hartuara nga subjekte udhëheqëse të këtyre projekteve e të paraqitura nga aplikuesi, si bashkëpjesëmarrës në hartimin e tyre.

Neni 12

Regjistrat profesionalë

1. Sekretariati teknik është përgjegjës për hartimin, përditësimin dhe publikimin në faqen zyrtare elektronike të ministrisë përgjegjëse, për ndërtimin e:

a) regjistrat profesional për licencat profesionale individuale për studim e projektim;



b) regjistrin profesional për licencat profesionale të shoqërive për studim e projektim;

c) regjistrin profesional për licencat profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim;

ç) regjistrin profesional për licencat profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim.

2. Elementet, që publikohen në regjistrat sipas pikës 1, të këtij neni, janë:

a) numri i licencës;

b) emri, mbiemri për individët, emri i shoqërisë, në rastin e shoqërive;

c) statusi i saj;

ç) afati i vlefshmërisë së licencës, në rastin e shoqërive;

d) emri i përfaqësuesit ligjor, në rastin e shoqërive;

dh) rezidenca.

3. Të dhënat e licencave profesionale, që miratohen nga Komisioni, regjistrohen në regjistrat profesionale të licencave profesionale individuale dhe të shoqërive.

4. Të dhënat përditësohen në përputhje me ndryshimet që pësojnë licencat, si rezultat i aplikimeve dhe i vendimmarrjeve të Komisionit për miratimin e aplikimeve apo dhënien e masave administrative.

5. Regjistrat profesionale janë dokumente publike, të cilat, në përgjegjësinë e sekretariatit teknik, publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin dhe u mundësohet akses në to, vetëm për lexim, çdo subjekti publik apo privat.

KREU III

LICENCAT PROFESIONALE – KATEGORITË, ELEMENTET DHE KUFIZIMET

Neni 13

Licenca – kategoritë e punimeve

1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrorë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.

2. Format i licencave profesionale është sipas shtojcës nr. 7, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

3. Kategoritë e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim përfitohen mbështetur

në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale, sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore.

4. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen e jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në shtojcën nr. 4, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

Neni 14

E drejta për pajisje me licencë

1. Çdo individ apo shoqëri, vendas/e ose i/e huaj, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ka të drejtë të paraqesë aplikim për t'u pajisur me licencë profesionale, pranë Komisionit të Posaçëm të Dhënies së Licencave Profesionale pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.

2. Kushtet e kriteret specifike, të cilat kërkohen në përgjithësi, për të fituar kategoritë e veprimtarisë në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, jepen në nenet 19, 26, 27 e 28 të kësaj rregulloreje dhe në shtojcat nr. 4 e nr. 5 të rregullores.

Neni 15

Llojet e licencave dhe elementet e saj

1. Llojet e licencave janë:

a) licencë profesionale individuale;

b) licencë profesionale për shoqëri.

2. Licencat profesionale individuale, apo për shoqëri, jepen për këto veprimtari:

a) studim e projektim në ndërtim;

b) mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

3. Licencat përmbajnë elemente, sipas shtojcës 7:

a) Të dhënat e individit (emri, mbiemri, atësia, ditëlindja, vendbanimi) apo të shoqërisë disponuese (përfshirë emërtimin e shoqërisë, drejtuesin ligjor dhe drejtuesin teknik);

b) Titullin e diplomës së individit dhe vitin e diplomimit, për licencat individuale;

c) Datën e regjistrimit në regjistrat profesionale përkatës;

ç) Kategoritë për veprimtaritë që ka të drejtë të ushtrorë disponuesi;

d) Afatin e vlefshmërisë për rastet e shoqërive;

dh) Numrin unik të licencës profesionale;

e) Adresën.



Neni 16

Kufizime për tërheqjen dhe përdorimin e licencave

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një individ apo shoqëri tek tjetri/a.
2. Kur një individ apo shoqëri humbet licencën profesionale, njofton menjëherë, zyrtarisht, sekretariatit teknik. Do të pranohen e do të trajtohen vetëm aplikime për licenca të miratuara para datës 1.5.2022.
3. Nëse drejtuesit teknikë shkelin ndalimet e pikës 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje, gjatë kohës që Komisioni shqyrton marrjen e masave të përcaktuara në këtë rregullore, licenca e tyre pezullohet.

Neni 17

Kufizime në dhënien e licencave

1. Nuk shtohen në rolin e drejtuesit teknik për shoqëri, në licencën që përfiton shoqëria, personat që punojnë në institucionet shtetërore qendrore, vendore apo të pavarura, aktiviteti i të cilëve bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil dhe krijon konflikt interesi.
2. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë persona, që janë të angazhuar me kohë të plotë në punëmarrje tjetër, por vetëm me kohë të pjesshme dhe nuk mund ta ushtrojnë detyrën e drejtuesit teknik në më shumë se një shoqëri. Nëse puna me kohë të pjesshme lidhet me një aktivitet në fushën e projektimit, të zbatimit të punimeve në ndërtim apo të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, personi e ka të ndaluar të zbatojë detyra për të njëjtat ndërtime apo vepra të ndjekura nga shoqëria, në të cilën ai ushtron detyrën e drejtuesit teknik. Subjekti duhet të dokumentojë punësimin me kohë të pjesshme.

Neni 18

Afatet e vlefshmërisë së licencave

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave, nga data e miratimit të tyre, janë, si më poshtë vijon:
 - a) Për licencë profesionale të shoqërive për studim e projektim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës, që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknik/ë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të shkurtër), por jo më shumë se 5 vjet; për subjektet e

huaja do të jetë sa kontrata, nëse i ka me afat jo me shumë se 5 vjet e, nëse nuk janë me afat, licenca do të jetë e vlefshme për 5 vjet;

b) Për licencë profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës, që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknikë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të shkurtër), por jo më shumë se 5 vjet; për subjektet e huaja do të jetë sa kontrata, nëse i ka me afat, jo më shumë se 5 vjet dhe, nëse nuk janë me afat, licenca do të jetë e vlefshme për 5 (pesë) vjet;

c) Licencat individuale jepen me afat të përhershëm.

2. Afati kohor minimal për të kërkuar shtesë të kategorive në licencën profesionale individuale dhe të shoqërive është jo më pak se një vit. Nuk zbatohet ky afat në rastin e aplikimit për përfitimin e kategorive shtesë, si rrjedhim i ndryshimit apo i shtesës së drejtuesve teknikë në shoqëri, të cilët plotësojnë kriteret e kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe në shtojcat e saj.

KREU IV

RREGULLAT PËR PAJISJE ME LICENCË PROFESIONALE INDIVIDUALE

Neni 19

Kushtet paraprake dhe kufizimet për licencë profesionale individuale

1. Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, për studim e projektim, janë:

a) Të disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të nivelit të dytë ose ekuivalent (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja, të njohur e njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) Të ketë eksperiencë në projektim, në institucione publike projektuese, shoqëri studimi e projektimi, persona fizikë që ushtrojnë veprimtari profesionale në studim e projektim, ose institucione të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur,



pas përfundimit të një programi studimi të arsimit të lartë të ciklit të dytë ose ekuivalente me të.

2. Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim, janë:

a) Të disponojë diplomë të ciklit të dytë të arsimit të lartë ose ekuivalente me të, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja, të njohur e të njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) Të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë në studime e projekte, apo zbatimin në ndërtim, në profesionin përkatës, pas përfundimit të një programi studimi të arsimit të lartë të ciklit të dytë ose ekuivalente me të.

3. Në rastin e individit të licencuar në fushën e studimit, të projektimit dhe në fushën e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, vetëm kur ai ushtron detyrën e drejtuesit teknik pranë një shoqërie, për rinovimin dhe shtesën e kategorive të licencës së tij, kërkesa duhet të paraqitet nga shoqëria, pranë së cilës ai ushtron këtë detyrë.

4. Si për licencë në fushën e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit, ashtu edhe në atë të projektimit, kufizimi konsiston në ndalimin e pajisjes me licencë, nëse individit është sanksionuar me heqje të së drejtës për ushtrimin e aktivitetit të licencuar nga komisioni për shkëljen e ndalimit të konfliktit të interesit, të parashikuar në pikën 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje. Kohëzgjatja e ndalimit përcaktohet në vendimin e Komisionit për zbatimin e njëres prej masave, sipas nenit 42 të kësaj rregulloreje.

5. Kushtet e mësipërme paraprake vlejné dhe për individët e huaj, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale.

Neni 20

Pajisja me licencë profesionale individuale për herë të parë

1. Aplikimi për pajisje me licencë individuale për herë të parë, pasi të plotësohen kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin “*e-Albania*”, sipas kategorive të punimeve, me të cilat individit kërkon të licencohet;

b) diplomën që zotëron, e skanuar me originalin/të njësuar me originalin;

c) jetëshkrimin (CV-në) e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës;

ç) dokumentacionin teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën, ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të projektuesit që ka hartuar projektin, si dhe nënshkrimin e tij, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

d) vetëdeklarimin e individit mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*”, gjatë procesit të aplikimit;

dh) në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij, në shtojcë në lidhje me punësimin, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje, dhe sipas formatit 6/2, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje. Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*”, gjatë procesit të aplikimit.

Neni 21

Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale

1. Aplikimi për pajisje me shtesa në licencën individuale ekzistuese, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, kryhet në portalin “*e-Albania*” dhe, shoqërohet me:



a) aplikimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, ku të përcaktohen kategoritë, të cilat individit kërkon të shtohen në licencën, që disponon nga një aplikim i mëparshëm;

b) CV-në e aplikantit, ku të pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi paraardhës;

c) dokumentacionin teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV, vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku ka qenë bashkautor personi; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën, ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet e projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike, si dhe nënshkrimin e subjektit, që ka lëshuar vërtetimin, apo të projektuesit, që ka hartuar projektin; në të kundërt, dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

ç) vetëdeklarimin e individit mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin *e-Albania*, gjatë procesit të aplikimit;

d) në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në shtojcë në lidhje me punësimin, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje, dhe sipas formatit 6/2, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje. Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*”, gjatë procesit të aplikimit.

Neni 22

Për dublikatë të licencës individuale

Aplikimi për pajisjen me dublikatë të licencës individuale (pranohet dhe trajtohet vetëm aplikimi për dublikatë për licencat e përfuturara para datës 1.5.2022), pasi të plotësohen kufizimet e kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, kryhet në portalin “*e-Albania*” dhe shoqërohet me vetëdeklarimin e individit mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të

licencohet, si dhe nëse ka apo jo penalizime nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formatit 6/3, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*” gjatë procesit të aplikimit.

Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në shtojcë në lidhje me punësimin, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje, dhe sipas formatit 6/2, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*”, gjatë procesit të aplikimit.

Neni 23

Për rinovimin e kategorive të licencës individuale

1. Aplikimi për rinovimin e kategorive të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, kryhet në portalin “*e-Albania*” dhe shoqërohet me:

a) aplikimin e individit, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të rinovohet;

b) vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formatit 6/3, të lidhjes nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin *e-Albania*, gjatë procesit të aplikimit.

Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në shtojcë në lidhje me punësimin, sipas përcaktimeve të nenit 17, pikat 1 dhe 2 dhe sipas formatit 6/2 të shtojcës nr. 6. Vetëdeklarimi kryhet në portalin *e-Albania*, gjatë procesit të aplikimit;

c) veprimtarinë e tij të kryer nga aplikimi paraardhës në formën e CV-së;

ç) dokumentacionin teknik justifikues për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku ka qenë bashkautor



personi; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit, që ka lëshuar vërtetimin apo të projektuesit, që ka hartuar projektin; në të kundërt, dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.

Neni 24

Ndryshim dhe shtesë në emrin/mbiemrin në licencë individuale

Aplikimi për ndryshim dhe shtesë në emrin/mbiemrin në licencë individuale kryhet në portalin “e-Albania” dhe shoqërohet, me:

a) aplikimin e individit, ku të përcaktohen të dhënat e licencës, që ndryshohen/shtohen;

b) vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “e-Albania” gjatë procesit të aplikimit.

Neni 25

Për ekuivalentimin e licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës (jo Shqipëri)

Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale individuale, që individët kanë përfutur në vende të huaja, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin “e-Albania”, ku të përcaktohen kategoritë, me të cilat individit kërkon të licencohet dhe ato, që ai mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;

b) dokumentin e identitetit që disponon;

c) diplomën që disponon në vendin e origjinës, të njohur e të njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar;

ç) licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon në vendin e origjinës, të njohur dhe njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

d) veprimtarinë e tij të kryer nga marrja e diplomës, në formën e CV-së;

dh) dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin, apo të projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

e) vetëdeklarimin e individit mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/3, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në shtojcë në lidhje me punësimin, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje, dhe sipas formatit 6/2, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “e-Albania”, gjatë procesit të aplikimit.

KREU V

RREGULLAT PËR PAJISJE ME LICENCË PROFESIONALE SHOQËRIE

Neni 26

Kushtet paraprake për drejtuesit teknikë të shoqërisë

1. Kushtet paraprake për të pasur pozicionin e drejtuesit teknik të shoqërisë janë, si më poshtë vijon:



a) Drejtuesi teknik i shoqërisë për studime e projekte është një ose më shumë individë, që disponon diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të nivelit të dytë ose ekuivalent; të jetë i pajisur me licencë profesionale individuale ose përfiton licencë profesionale individuale për herë të parë. Në rastet kur personi përfiton licencë profesionale individuale për herë të parë, ai shtohet si drejtues teknik në licencën e shoqërisë vetëm pas miratimit të licencës profesionale individuale. Drejtuesi teknik të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pas diplomimit në nivelin master. Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin rezulton 9 ose më shumë, mund të regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vjet eksperiencë pas diplomimit në nivelin master. Drejtuesi teknik nuk mund të bëjë kërkesa individuale për aq kohë sa do të jetë drejtues teknik i një subjekti;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim është një ose më shumë individë, i pajisur me licencë profesionale individuale në fushën përkatëse ose që përfiton licencë profesionale individuale për herë të parë. Në rastet kur personi përfiton licencë profesionale individuale për herë të parë, ai shtohet si drejtues teknik në licencën e shoqërisë vetëm pas miratimit të licencës profesionale individuale. Drejtuesi teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim duhet të ketë vite eksperiencë, jo më pak se 15 vjet pas përfundimit të një programi studimi të arsimit të lartë të ciklit të dytë ose ekuivalente me të. Drejtuesi teknik nuk mund të bëjë kërkesa individuale për aq kohë sa do të jetë drejtues teknik i një subjekti. Çdo ndryshim në licencën e tij do të bëhet nëpërmjet subjektit, që është drejtues teknik;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi në dy ose më shumë shoqëri;

ç) Drejtuesi/drejtuesit teknik/ë duhet të jetë/jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit;

d) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë përcaktohen në kontratën e punës të lidhur ndërmjet tyre.

2. Shoqëria pajiset me licencë profesionale, mbështetur e në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ka ajo, aplikimeve të tjera, që caktohen në këtë rregullore,

dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

3. Në rastet e shoqërive të huaja, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte dhe kriteret paraprake si më sipër.

4. Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së huaj është i huaj, bëhet ekuivalentimi i licencës individuale të tij, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, dhe, gjithashtu, zbatohen të njëjtat kushte paraprake, si për shoqëritë vendase.

Neni 27

Kushtet paraprake për licencë profesionale shoqërie

1. Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri për studimin e projektimit janë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë regjistruar si person juridik dhe të ketë status aktiv, sipas dispozitave ligjore për të ushtruar veprimtari në studim e projektim;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për studim e projektim ose, në rast se nuk është i pajisur me licencë, drejtuesi teknik duhet të plotësojë kriteret e kushtet e përcaktuara në nenin 19, të kësaj rregulloreje, për t'u pajisur me licencë profesionale individuale;

c) Të mos ketë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.

2. Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi janë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë regjistruar si person juridik dhe të ketë status aktiv, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në mbikëqyrje e kolaudim;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim, ose, në rast se nuk është i pajisur me licencë, drejtuesi teknik duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në nenin 19, të kësaj rregulloreje, për t'u pajisur me licencë profesionale individuale;

c) Të mos ketë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.



Neni 28

Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëritë e huaja

1. Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëritë e huaja për studim e projektim, janë, si më poshtë vijon:

a) Të jenë të regjistruara si degë e shoqërisë së huaj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit vendas ose të jenë të regjistruar si person juridik dhe të kenë status aktiv, sipas dispozitave ligjore, në vendin e origjinës;

b) Të kenë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për studim e projektim ose, në rast se nuk është i pajisur me licencë individuale, drejtuesi teknik duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë rregullore për t'u pajisur me licencë profesionale individuale;

c) Të kenë vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësueseve ligjor/ë lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi në vendin e origjinës.

2. Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëritë e huaja për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi janë, si më poshtë vijon:

a) Të jenë të regjistruara si degë e shoqërisë së huaj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit vendas ose të jenë të regjistruar si person juridik dhe të kenë status aktiv, sipas dispozitave ligjore, në vendin e origjinës;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim ose, në rast se nuk është i pajisur me licencë, drejtuesi teknik duhet të plotësojë kriteret e kushtet e përcaktuara në këtë rregullore për t'u pajisur me licencë profesionale individuale;

c) Të kenë vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësueseve ligjor/ë lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi në vendin e origjinës.

Neni 29

Detyrimet e subjekteve të licencuara

1. Detyrimet e subjekteve të licencuara janë, si më poshtë vijon:

a) Të njohin dhe të kryejnë veprimtari, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë

fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit;

b) Të njohin e të zbatojnë standardet, kushtet teknike të projektimit, si dhe normat e standardet evropiane të pranuar nga vendi ynë;

c) Çdo subjekt i licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të drejtuesit/drejtuesve teknik/ë;

ç) Subjekti duhet të ketë statusin “aktiv” të ushtrimit të veprimtarisë, dëshmuar me dokumentin përkatës (ekstrakti historik apo ekstrakti për të dhënat e subjektit) të Qendrës Kombëtare të Biznesit;

d) Në rast largimi nga shoqëria e drejtuesit teknik apo të përfundimit të marrëdhënies së punës, si drejtuesi teknik dhe shoqëria detyrohen të njoftojnë Komisionin brenda 7 ditëve punë. Në këtë rast, sekretariati, brenda 5 ditëve punë nga marrja e njoftimit prej drejtuesit teknik, njofton shoqërinë që, brenda 30 ditëve nga largimi i drejtuesit teknik, duhet të bëjë emërimin e drejtuesit teknik të ri;

dh) Në rast se drejtuesi teknik dhe shoqëria nuk njofton brenda 7 ditëve punë sekretariatit për largimin e drejtuesit teknik, sipas përcaktimit në shkronjën “d”, të kësaj pike, ndaj shoqërisë dhe/ose drejtuesit teknik merret masë administrative, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

e) Shoqëria duhet të bëjë emërimin e drejtuesit teknik të ri, brenda 30 ditëve nga largimi i drejtuesit teknik;

ë) Çdo ushtrim veprimtarie nga shoqëria, pa drejtues teknik, shoqërohet me masë administrative kundrejt shoqërisë, sipas përcaktimeve të nenit 42, të kësaj rregulloreje.

2. Subjektet e licencuara vetëdeklarojnë njohjen e kushteve teknike të projektimit, si dhe normat e standardet evropiane të pranuar nga vendi ynë.

Neni 30

Për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë

1. Aplikimi për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin “e-Albania”, ku të përcaktohen përfaqësuesit ligjorë dhe drejtuesit teknikë të shoqërisë;



b) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë dhe të shoqërisë mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, ku kërkon të licencohet, dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1, të lidhjes nr. 6, të kësaj rregulloreje);

c) kontratën ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

ç) vetëdeklarimin e drejtuesit/drejtuesve teknik/ë:

i. për gjendjen gjyqësore të tij dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii. për gjendjen, lidhur me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publikë (sipas formatit 6/5, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

d) Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë, për individin që kërkon të regjistrohet drejtues teknik, rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vjet eksperiencë, paraqitet edhe lista e notave.

2. Sekretariati, nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave, gjeneron:

a) ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

b) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

3. Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknik/ë, aplikimi hartohet e dërgohet bashkërisht pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 31

Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë

1. Aplikimi për pajisje me shtesa të kategorive në licencën ekzistuese të shoqërisë (në rastet kur nuk kërkohen ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik

të shoqërisë), pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin “e-Albania”, ku të përcaktohen, të paktën, kategoritë që kërkohen të shtohen;

b) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjor/ë dhe të shoqërisë mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, ku kërkon të licencohet, dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formateve 6/1 e 6/6, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

c) vetëdeklarimin e drejtuesit/drejtuesve teknik/ë:

i. për gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii. për gjendjen lidhur me punësimin si drejtues teknik, në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publikë (sipas formatit 6/5, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje).

2. Sekretariati, nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave, gjeneron vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

3. Drejtuesi teknik plotëson dokumentacionin për shtesa në licencën e tij individuale (të cilat i kalojnë automatikisht shoqërisë), sipas përcaktimeve të nenit 21, të kësaj rregulloreje, përjashtuar vetëdeklarimin, i cili duhet të hartohet sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 32

Për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë

1. Aplikimi për zgjatjen e afatit të licencës ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknikë të shoqërisë, apo rinovim të kategorive), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:



a) aplikimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, që kërkon zgjatje të afatit të licencës apo dublikatë;

b) kontratat ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratat të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;

c) vetëdeklarimin e përfaqësuesve ligjorë dhe shoqërisë, në shtojcë me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilicencohet, si dhe gjendjen në shtojcë me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formateve 6/3 dhe 6/6, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

ç) vetëdeklarimin e drejtuesit/drejtuesve teknik/ë:

i. për gjendjen e tij gjyqësore dhe të ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii. për gjendjen në shtojcë me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publikë (sipas formatit 6/5, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje).

2. Sekretariati, nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave, gjeneron vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

3. Subjektet mund të bëjnë aplikim në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” për dublikatë. Subjektet, në këtë rast, duhet të përcaktojnë të dhënat e licencës, që kërkojnë të dublohet dhe arsyet e aplikimit për dublikatë. Kjo pikë është e zbatueshme për licenca të miratuara para datës 1.5.2022.

Neni 33

Për rinovimin e kategorive të licencës së shoqërisë

1. Aplikimi për rinovimin e kategorive të licencës së shoqërisë, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, ku të përcaktohen, të paktën, të dhënat e licencës së disponuar më parë;

b) dokumentacionin teknik justifikues mbi veprimtarinë e kryer nga shoqëria; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, që kanë lidhje me fushën, ku kërkon të licencohet; projekte (ose pjesë të tyre). Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të projektuesit që ka hartuar projektin; në të kundërt, dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

c) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjor/ë dhe të shoqërisë mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilicencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit në këtë fushë (sipas formateve 6/3 dhe 6/6, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

ç) kontratat ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratat të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;

d) vetëdeklarimin e drejtuesit/drejtuesve teknik/ë.

2. Sekretariati, nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave, gjeneron vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

3. Ky aplikim shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 23, të kësaj rregulloreje (për rinovimin e kategorive të licencës individuale), për drejtuesit teknikë, për të cilët kërkohet rinovimi i kategorive. Në rast rinovimi të kategorive të licencës individuale të drejtuesit teknik, për kategoritë që përfiton shoqëria për shkak të shtimit të drejtuesit teknik me kategoritë e rinovuara, shoqërisë i shtohen kategoritë e rinovuara.

Neni 34

Për ndryshim ose shtesë të përfaqësuesit ligjor

1. Aplikimi për ndryshimin ose shtimin e përfaqësuesit ligjor, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake të parashikuara në nenin 19, të kësaj rregulloreje, shoqërohet edhe me:

a) aplikimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”;



b) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjor/ë të ri/nj dhe shoqërisë, mbi gjendjen e tij/tyre gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, në lidhje me fushën ku është/janë licencuar dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e saj/tyre kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formateve 6/1 e 6/6, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje).

2. Sekretariati, nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave, gjeneron:

a) ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

b) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

Neni 35

Për ndryshim ose shtesa të drejtuesit/drejtuesve teknikë

1. Aplikimi për ndryshim ose shtesa të drejtuesit teknik, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Aplikimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, ku të përcaktohen, të paktën, të dhënat e licencës së disponuar më parë, drejtuesit teknikë që do të largohen dhe ata që do të shtohen;

b) Vetëdeklarimin e përfaqësuesit ligjor dhe shoqërisë, mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, në lidhje me fushën ku është licencuar dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 dhe 6/6 të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

c) Kontratat ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë të rinj, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

ç) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i. mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii. për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore,

të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

d) Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin, që kërkon të regjistrohet drejtues teknik, rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vjet eksperiencë, paraqitet edhe lista e notave.

2. Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri, aplikimi hartohet dhe dërgohet bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 36

Për ndryshim emërtim dhe/ose selie shoqërie

1. Aplikimi për ndryshim të emërtimit të shoqërisë bëhet në portalit unik qeveritar “*e-Albania*”.

2. Sekretaria verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve sipas kësaj rregulloreje dhe nëpërmjet ndërveprimit të sistemit të licencave gjeneron:

a) Ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

b) Vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

Neni 37

Ndryshim dhe shtesë në emrin/mbiemrin e individëve në licencën e shoqërisë

Aplikimi për ndryshim dhe shtesë në emrin/mbiemrin e individëve në licencën e shoqërisë bëhet në portalit unik qeveritar “*e-Albania*” shoqërohet, me:

a) Aplikimin në portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, ku të përcaktohen ndryshimet në lidhje me emrin, mbiemrin e drejtuesit teknik;

b) Vetëdeklarimin e individit mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1, të shtojcës nr. 6). Vetëdeklarimi kryhet në portalin “*e-Albania*”, gjatë procesit të aplikimit.



Neni 38

Për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës

1. Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale, që kanë përfituar shoqëritë e huaja në vendin e origjinës, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet paraprake, të parashikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) aplikimin në portalin unik qeveritar “e-Albania”, sipas kriterëve të nenit 27, të kësaj rregulloreje, ku të përcaktohen kategoritë, sipas kategorive të punimeve, me të cilat shoqëria kërkon të licencohet dhe ato që mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;

b) ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit, me status aktiv, të regjistruar, sipas dispozitave ligjore, në vendin e origjinës;

c) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjor/ë dhe shoqërisë mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe ndjekjes penale nga organet e prokurorisë, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formateve 6/3 e 6/6, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

ç) kontratën ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të përkthyer e të njësuar me origjinalin (noterizuar);

d) vetëdeklarimin e drejtuesit/drejtuesve teknik/ë:

i. për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii. për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5, të shtojcës nr. 6, të kësaj rregulloreje);

dh) licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon shoqëria dhe drejtuesit teknikë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njohur dhe njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, sipas

dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar;

e) diplomën që disponon drejtuesi/drejtuesit teknik/ë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njohur dhe të njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar;

ë) veprimtarinë e kryer nga shoqëria nga marrja e licencës në vendin e origjinës në formën e CV-së;

f) dokumentacionin teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV: vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre); certifikata vlerësimi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshtirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të projektuesit që ka hartuar projektin; në të kundërt, dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

g) vetëdeklarimin e përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjor/ë mbi gjendjen në lidhje me shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të mos jetë/jenë në proces falimentimi apo likuidimi në vendin e origjinës.

2. Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë, që shtohen në shoqëri, aplikimi hartohet dhe dërgohet bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

3. Në rastet kur drejtuesi teknik nuk ka licencë, ai duhet të paraqesë diplomën e njohur dhe të njësuar nga institucioni përgjegjës për njohjen e njësimin në Republikën e Shqipërisë.

4. Në rastet kur aplikuesi në vendin e origjinës nuk ka licencë, aplikuesi në aplikimin e tij duhet të evidentojë faktin që, sipas legjislacionit në fuqi, në vendin e origjinës, ushtrimi i veprimtarisë kryhet pa licencë dhe vlerësimi nga Komisioni do të bëhet duke u bazuar në plotësimin e kushteve dhe të kriterëve të tjera të parashikuara në këtë rregullore dhe veçanërisht në dokumentacionin teknik të justifikuar sipas shkronjës “P”, të pikës 1, të këtij neni.



Neni 39

Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë

1. Në rast të përfundimit/mbylljes së aktivitetit të shoqërisë, shoqëritë duhet të njoftojnë Komisionin, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor, dhe të dorëzojnë licencën e lëshuar para datës 1.5.2022.

2. Në rast të përfundimit/mbylljes së aktivitetit të shoqërisë, licenca e dhënë në bazë të kësaj rregulloreje shfuqizohet automatikisht.

KREU VI**FUNKSIONIMI I SISTEMIT
INFORMATIK TË INTEGRUAR**

Neni 40

Sistemi informatik i integruar

1. Institucioni përgjegjës për gjenerimin dhe përditësimin e të dhënave në sistemin informatik të integruar, sipas këtij vendimi, është ministria përgjegjëse për ndërtimin.

2. Të dhënat parësore, që përmban sistemi informatik i integruar, janë:

- a) data e vendimit;
- b) numri i vendimit;
- c) fusha e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë;
- ç) kategoritë e punimeve;
- d) afati i vlefshmërisë për subjektet juridike.

3. Të dhënat dytësore, që përmban sistemi informatik i integruar, janë të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) Emri, mbiemri;
- b) Numri personal i identifikimit (NID);
- c) NIPT-i për subjektin juridik;
- ç) Vërtetimi nga organet tatimore për shlyerjen nga subjekti të të gjitha detyrimeve tatimore;
- d) Emri i subjektit juridik;
- dh) Emri, mbiemri i drejtuesit ligjor të subjektit juridik;
- e) Emri, mbiemri i drejtuesit teknik të subjektit juridik;
- ë) Numri i licencës.

Neni 41

Ndërveprimi i sistemit informatik të integruar

1. Sistemi informatik i integruar ndërvepron me baza të tjera të dhënash, si:

- a) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- b) regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- c) portali unik qeveritar “e-Albania”;
- ç) Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve;
- d) tatimi elektronik, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. Dhënës të informacionit në sistemin e integruar janë:

- a) drejtoritë rajonale të tatimeve;
- b) individë/personat fizikë apo juridikë, që kërkojnë të pajisen me licencë në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes.

3. Subjekte të interesuara janë të gjithë individët/personat fizikë apo juridikë, të cilët kërkojnë të përdorin sistemin informatik të integruar, për kryerjen e procedurave të aplikimit për t’u pajisur me licencën përkatëse, sipas dispozitave të këtij vendimi.

4. Niveli i aksesimit në sistemin e integruar është, si më poshtë vijon:

a) ministria përgjegjëse për ndërtimin ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në sistemin e integruar;

b) subjektet e interesuara, sipas pikës 3, të këtij neni, kanë akses në leximin e statusit të aplikimit dhe komenteve, dhe gjenerimin e licencës apo kthimin e përgjigjes, për sa u përket të dhënave dhe dokumenteve, të cilat përpunohen dhe përditësohen nga ministria përgjegjëse për ndërtimin, si dhe dhënien e informacionit apo të dhënave të nevojshme që kërkojnë gjatë procedurës së aplikimit.

KREU VII**MASAT ADMINISTRATIVE DHE
DISPOZITA KALIMTARE**

Neni 42

Masat administrative ndaj subjekteve të licencuara

1. Komisioni merr vendime ndaj individëve dhe shoqërive të licencuara, duke vendosur masën e heqjes së të drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, tërësisht ose pjesërisht, për kategoritë që disponon në licencë, në rastet kur:



a) konstatohen deklarime të rreme apo dokumente të pavërteta;

b) kryen veprimtari pa drejtues teknik/nuk plotëson detyrimet e kufizimet, që rrjedhin nga kjo rregullore;

c) drejtuesi teknik largohet nga shoqëria dhe nuk respekton procedurat e përcaktuara në nenin 29 të kësaj rregulloreje;

ç) shoqëria nuk respekton procedurat e përcaktuara në nenin 29, të kësaj rregulloreje, në rastin e largimit të drejtuesit teknik.

2. Për çdo rast, nga sekretariati teknik paraqitet materiali për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Komisionit, së bashku me raportin e vlerësimit të grupit të ekspertëve, në rastin kur është kërkuar nga Komisioni.

3. Masat administrative që merr Komisioni, janë:

a) “Heqje të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 6 muaj”, kur vërtetohet, se ka kryer shkelje të përcaktuara në njërin nga rastet e pikës 1, të këtij neni, por jo në mënyrë të përsëritur;

b) “Heqje të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 1 vit”, kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara, në njërin nga rastet e pikës 1, të këtij neni, në mënyrë të përsëritur;

c) “Heqje të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 3 vjet”, kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara, në njërin nga rastet e pikës 1, të këtij neni, edhe pasi subjekti ka ezauruar kohën e sanksionit nga një pezullim i mëparshëm;

ç) “Heqje të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 5 vjet”, për rastet kur është konstatuar ushtrim veprimtarie pa disponuar licencë të vlefshme për atë lloj veprimtarie ose ushtrim aktiviteti brenda afatit të një penalizimi.

4. Për masat e vendosura nga Komisioni njoftohet, brenda pesë ditëve, subjekti, ndaj të cilit është vendosur masa dhe struktura përgjegjëse për inspektimin në këtë fushë. Për rastet e deklarimeve të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen edhe me kallëzim në organet kompetente.

Neni 43

Ankimi

1. Individët apo përfaqësuesit e shoqërive, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, kanë të drejtën e ankimit pranë Komisionit për çdo vendim që ka marrë ky i fundit, përveç atyre vendimeve që lidhen me sanksionet e parashikuara në nenin 42, të kësaj

rregulloreje. Afati kohor për të bërë ankimin sipas kësaj pike është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit që po ankimohet.

2. Komisioni, për ankimet që bëhen sipas pikës 1, të këtij neni, vendos brenda 20 (njëzet) ditëve për pranimin ose mospranimin e ankesës.

3. Në rast të mospranimit të ankesës, subjektet e interesuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës. Ministri, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 20 (njëzet) ditëve, për mospranimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të marrë në Komision.

4. Individët apo përfaqësuesit e shoqërive kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës për çdo vendim të Komisionit për sanksione sipas kreut VII të kësaj rregulloreje. Afati kohor për të bërë ankimin, sipas kësaj pike, është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

5. Ministri përgjegjës, për shqyrtimin e ankimit, sipas pikës 4, të këtij neni, vendos, brenda 20 (njëzet) ditëve, për mospranimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të marrë në Komision.

SHTOJCAT

Shtojca 1: Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim

Shtojca 2: Kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim

Shtojca 3: Shpjegime për kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim

Shtojca 4: Kushte dhe kriteret specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit

Shtojca 5: Kushte dhe kriteret specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim

Shtojca 6: Vetëdeklarimet

Shtojca 7: Formatet e licencave



SHTOJCA 1

KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT
DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM

1. PROJEKTIM URBANISTIK

a- 1. Plane kombëtare sektoriale; 2. Plane të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

b- 1. Plane sektoriale në nivel qarku; 2. Plane sektoriale në nivel bashkie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

c- Plane të detajuara vendore.

d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqesh të gjelbra, lulishte e parqe.

2. PROJEKTIM ARKITEKTUROR

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike.

b-1. objekte sportive; 2. qendra tregtare; objekte sociale e kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; 4. terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.

c- Projektim interior/exterior.

3. PROJEKTIM KONSTRUKTOR

a- Objekte civile - industriale prej murature e skelet betonarme, objekte metalike dhe me skelet metalik deri në 5 kate.

b-1. Objekte civile - industriale prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate – 2. objekte metalike dhe me skelet metalik mbi 5 kate.

c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie betonarme – metalike – 2. Objekte në troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej betonarme, murature dhe metalike.

e- Objekte civile e turistike prej druri.

4. PROJEKTIM INSTALATOR

a- Instalime hidro-termosanitare.

b- Instalime 1. termoteknike-kondicionimi, 2. të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

c- Linja e rrjete elektrike, për objekte civile e industriale.

d- Sisteme komplekse të telekomunikacionit.

e- Sisteme të furnizimit me gaz.

f- Sisteme kundra zjarrit.

g- Sisteme të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

h- Impiante ngritëse e transportuese.

i- 1. Ndriçim i shesheve dhe dekorim; 2. ndriçim i objekteve të mëdha sportive, porteve, aeroporteve dhe infrastrukture etj.

j- Rrjete të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV-së, *access control*, CCTV-së, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

5. PROJEKTIM HIDROTEKNIK

a- Digave dhe dambave të mëdha (digave dhe dambave me lartësi mbi 10–15 m ose me vëllim uji të grumbulluar mbi 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige mbi 500 m).

b- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c- Ujësjellës-kanalizime urbane-rurale.

d- Vepra ujitjeje – kullimi – impiante vaditëse – diga dhe damba të vogla – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

e- Vepra të trajtimit të ujit.

f- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi – shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë, prita malore dhe marrja e ujit me puse.

g- Vepra naftësjellës – gazsjellës – vajsjellës etj.

h- Vepra hidroteknike – kulla ekuilibri – porte – pontile.

i- Impiante të trajtimit të ujërave të zeza.

6. PROJEKTIM RRUGE – HEKURUDHA

a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

c- Autostrada.

d- Aeroporte – heliporte – hidroporte.

e- Hekurudha.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a- Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

b- Ura dhe vepra arti mbi 10 m.

c- Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.

d- Ura metalike.

e- Tunele rrugore dhe hekurudhore.

8. PROJEKTIM GJEODET

a- Rivelime inxhinierike.

b- Rilevime inxhinierike kadastrale.

c- Sisteme GIS.

d- Bazamente gjeodezike.



e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri në 5 kate.

b- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike mbi 5 kate.

c- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.

d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

e- Studim e projektim hidrogeologjik.

10. PROJEKTIM I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

a- Centrale hidraulike.

b- Centrale termike.

c- Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme.

d- Nënstacione elektrike, primare, sekondare dhe linja të tensionit të lartë.

e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës dhe linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTIM TË SINJALIZIMIT RRUGOR

a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë rurale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhë.

c- Sinjalistikë jondriçuese në aeroporte dhe heliporte.

d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

12. STUDIM SIZMOLOGJIK INXHINIERIK

a- Studim/vlerësim sizmologjik inxhinierik për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b- Studim/vlerësim gjeologo-sizmik për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

c- Studim/vlerësim sizmologjik inxhinierik për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve.

d- Studim/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse, si: hidrocentrale, termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.

e- Studim/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

f- Studim i rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

13. STUDIM E PROJEKTIM TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VEND-DEPOZITIMEVE TË MBE'TJEVE TË NGURTA (URBANE).

14. STUDIM E PROJEKTIM TË NDËRTIMIT TË IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

SHTOJCA 2

KATEGORITË NË FUSHATË MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1 Punime gërmimi në tokë.

NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.

NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-6a Diga të çdo lloj madhësie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

NP-6b Diga të vogla (diga me lartësi deri në 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri në 1 milion m³ ose me gjatësi kurore dige deri 500 ml).

NP-6c Tunele hidroteknike.

NP-7a Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditjeje.

NP-7b Vepra naftësjellës-gazsjellës-vajsjellës.

NP-8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).



NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

NS-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.

NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

NS-8a. Ndërtime parafabrikat betonarme.

NS-8b. Struktura metalike.

NS-8c. Struktura druri.

NS-9 Punime strukturore speciale.

NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

NS-11 Punime mbi shina dhe traversa.

NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV-je etj.

NS-15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.

NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

NS-17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

NS-21 Impiante të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridikë (shoqëri/studio).

SHTOJCA 3

SHPJEGIME PËR KATEGORITË NË FUSHAT E MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P.1 Punime gjërmimi në tokë

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdolloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

N.P.2 Ndërtime civile dhe industriale

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme, të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

N.P.3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen, gjithashtu, dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.P.4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet e realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe



artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P.5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

N.P.6a Diga të çdo lloj madhësie. Vetëm për personat juridikë (shoqëri/studio)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujën e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

N.P.6b Diga të vogla (diga me lartësi deri në 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige deri në 500 m)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujën e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

N.P.6c Tunele hidroteknike

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për qarkullimin e ujit për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

N.P.7a Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditjeje

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të

nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.P.7b Vepra naftësjellës-gazsjellës-vajsjellës

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet, që janë të nevojshme për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë, të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve.

N.P.8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që u përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujorë, ujësjellësit nënujorë, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimit në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

N.P.9 Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido



që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale, si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

N.P.10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë.

Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit, linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm, dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm, dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri tek përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdolloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

N.P.12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin

dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

I. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S-1 Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshirë edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorëve, shkallëve të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarëse të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshëm dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.



Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të të dhënave.

N.S-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

N.S-7 Barriera dhe mbrojtja rrugore

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi i elementeve si *guard rail*, *New Jersey*, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

NS-8a. Ndërtime parafabrikat betonarme

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

NS-8b. Struktura metalike

Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

NS-8c. Struktura druri

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elemente druri të drejta të trajtuara përpara.

N.S-9 Punime strukturore speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antizismik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe

marrijen e kampionëve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu, të provave me ngarkesë, të sondave të veprave, që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. *Impermeabilizime* dhe konsolidimin e terreneve.

N.S-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dysHEMEVE) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale.

N.S-11 Punime në shina dhe traversa

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike, ristrukturimi i binarëve për çfarëdolloj hekurudhe, metroje, tramvaji, si edhe sistemin e frenimit dhe automatizimin e stacioneve të mallrave.

N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që u përkasin kategorive të përgjithshme, që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV-je

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV-je, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.



N.S-15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore

“Deklaroj se nuk jam i punësuar me kohë të plotë në punëmarrje tjetër. Në rast se ushtroj një veprimtari me kohë të pjesshme në fushën e projektimit, zbatimit të punimeve në ndërtim, mbikëqyrjes ose kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, deklaroj se nuk do të kryej detyra për të njëjtat ndërtime apo vepra që ndiqen nga shoqëria në të cilën ushtroj detyrën e drejtuesit teknik dhe se do të dokumentoj marrëdhënien e punësimit me kohë të pjesshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

6/5.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklaroj: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me objektin e çështjes)



apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me objektin e ndjekjes).

“Gjithashtu deklaroj se: nuk jam i punësuar në rolin e drejtuesit teknik në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit.”

“Gjithashtu deklaroj se: nuk jam në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil dhe krijon konflikt interesi.”

“Deklaroj se nuk jam i angazhuar me kohë të plotë në punëmarrje tjetër.”

“Në rast se ushtroj një veprimtari me kohë të pjesshme në fushën e projektimit, zbatimit të punimeve në ndërtim, mbikëqyrjes ose kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, deklaroj se nuk do të kryej detyra për të njëjtat ndërtime apo vepra që ndiqen nga shoqëria në të cilën ushtroj detyrën e drejtuesit teknik dhe se do të dokumentoj

marrëdhënien e punësimit me kohë të pjesshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

6/6.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, në lidhje me fushën ku kërkon të licencohet (ose në rast se ka – të deklarohej: Ka çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me objektin e çështjes) apo/dhe është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me objektin e ndjekjes).”

“Shoqëria deklaron se njeh e do të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe/apo mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim sipas të gjitha ligjeve në fuqi në fushën e ndërtimit.”

Shtojca 7

FORMATET E LICENCEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe të Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë

X.XXXX

MBIEMRI	XXXXXX
EMRI	XXXXXX
ATËSIA	XXXXXX
DATELINDJA	XX.XX.XXX, XXXXX
VENDBANIMI	XXXXX
DIPLOMUAR, MË	XXXX
TITULLI	XXXXXX
Regjistruar në regjistrin profesional që nga data:	XX.XX.XXXX

NË PROJEKTIM

Kategoria	Numri i kategorisë sipas lidhjes nr.2	Gërma e kategorisë sipas lidhjes nr.2	Emërtimi i kategorisë sipas llojit përkatës, përcaktuar në lidhjen nr.2

KRYETARI I KOMISIONIT

XXXXXX XXXXX



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe të Mbikëqyrjes e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë**N.XXXX**

SHOQËRIA:	“XXXXXX”
DREJTUES LIGJOR:	XXXXX XXXXX
DREJTUES TEKNIK:	XXXXX XXXXX
ADRESA:	XXXXX
Regjistruar në regjistrin profesional që nga data:	XX.XX.XXXX

NE PROJEKTIM

Kategoria	Numri i kategorisë sipas lidhje, nr.2	Gërma e kategorisë sipas lidhjes nr.2	Emërtimi i kategorisë sipas llojit përkatës, përcaktuar në lidhjen nr.2

KRYETARI I KOMISIONIT**XXXXXXX XXXXX****Shënim: Kjo licencë është e vlefshme deri në datën XX.XX.XXXX.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe të Mbiqëqyrjes e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë

MK.XXXX

PËR MBIQËQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMI

MBIEMRI	XXXXXXX
EMRI	XXXXXXX
ATËSIA	XXXXXXX
DATELINDJA	XX.XX.XXX, XXXXX
VENDBANIMI	XXXXXX
DIPLOMUAR, MË	XXXX
TITULLI	XXXXXXX
Regjistruar në regjistrin profesional që nga data:	XX.XX.XXXX

Kategoria	Emërtimi i kategorisë
Lloji i kategorisë, sipas lidhjes nr.3	Emërtimi i kategorisë sipas llojit përkatës, përcaktuar në lidhjen nr.3

KRYETARI I KOMISIONIT

XXXXXXX XXXXX



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe të Mbiqëqyrjes e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë**MK.XXXX****PËR MBIQËQYRJE DHE KOLAUDIM TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT**

SHOQËRIA:	“XXXXXXX”
DREJTUES LIGJOR:	XXXXX XXXXX
DREJTUES TEKNIK:	XXXXX XXXXX
ADRESA:	XXXXX
Regjistruar në regjistrin profesional që nga data:	XX.XX.XXXX

Kategoria	Emërtimi i kategorisë
Lloji i kategorisë, sipas lidhjes nr.3	Emërtimi i kategorisë sipas llojit përkatës, përcaktuar në lidhjen nr.3

KRYETARI I KOMISIONIT**XXXXXXX XXXXX****Shënim: Kjo licencë është e vlefshme deri në datën XX.XX.XXXX.****UDHËZIM****Nr. 16, datë 8.7.2026****PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 23, DATË 9.12.2014, “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; si dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar; të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 10.8, të pikës 10, “Të tjera”, të udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014, pas kategorisë 41, shtohen kategoritë 42 dhe 43, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“- *Kategoria 42.* Personi, i cili në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve përkatëse është i pajisur me Certifikatë Mbulimi të Kontributeve, përjashtohet nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- *Kategoria 43.* Personi, i cili në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve



përkatëse është i pajisur me Certifikatë Mbulimi të Kontributeve, por me të drejtë zgjedhjeje, paguan kontribute të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi ose sipas përcaktimeve të marrëveshjes dypalëshe përkatëse.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

URDHËR

Nr. 365, datë 16.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për datën 17.7.2026, të zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Elona Hoxha.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Toni Gogu

URDHËR

Nr. 721, datë 13.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.

10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Durđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Draž*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Viroviticko-Podravska	Cmac*	
Viroviticko-Podravska	Zdenci*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të paineduara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave; ose



c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat, në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.



2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 653, datë 18.6.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri



URDHËR

Nr. 722, datë 13.7.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontener të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Piemonte	Alessandria	Montechiaro d'Acqui*
Toscana	Massa Carrara	Comano*
Toscana	Pistoia	San Marcello Pistoiese*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pafektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca



demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnavë në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnavë në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 687, datë 1.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Italisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 723, datë 13.7.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe e tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Kansas	Pratt*
2.	Texas	Shelby*
3.	Indiana	Elkhart*
4.	Indiana	Noble*
5.	Indiana	LaGrange*
6.	Illinois	Lawrence*
7.	Arkansas	Clay*
8.	South Dakota	Edmunds*
9.	New Jersey	Hunterdon*
10.	North Dakota	Dickey*



11.	Minnesota	Becker*
12.	Rhode Island	Providence*
13.	Utah	Cache*
14.	Idaho	Canyon*

Shënim. Simboli () nënkupton zönën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 706, datë 6.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM Nr. 56, datë 21.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 30.4.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (XH) 2025, që u përket:

KËRKUES: Xhonatan Muçaj, përfaqësuar nga studio ligjore “Interpartes” sh.p.k., nëpërmjet administratorit, avokatit Shkëlzen Selimi, me prokurë.

Nasi Hodo, përfaqësuar nga avokati Edmond Dema, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria E Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2079 (314), datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 28, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, Xhonatan Muçaj dhe Nasi Hodo (*kërkesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 521 (61-2019-7623), datë 27.12.2019 (*vendimi i shkallës së parë*), ka deklaruar fajtorë kërkuesit për: i. veprën penale të “Vrasjes me dashje”, në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit E.M., të parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal (KP); ii. veprën penale të “Vrasjes me dashje”, në bashkëpunim, në dëm të shtetasit P.B., të parashikuar nga neni 76 i KP-së; iii. veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje” ndaj shtetasit D.K., të parashikuar nga neni 89 i KP-së. Ajo gjykatë, në zbatim të nenit 55 të KP-së (“Caktimi i dënimeve për disa vepra penale”), ka bashkuar të gjitha dënimet në një të vetëm, duke i dënuar kërkuesit përkatësisht me 20 dhe 18 vjet burgim.

2. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit Vlorë, me anë të vendimit nr. 121 (60-2020-1061), datë 8.7.2020 (*vendimi i apelit*), ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë për kërkuesin Xhonatan Muçaj, vetëm për pjesën që ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje ndaj shtetasit D.K., si dhe për veprën penale të vrasjes me dashje ndaj viktimës P.B. dhe, duke bashkuar të gjitha dënimet në një të vetëm, e ka dënuar përfundimisht atë me 12 vjet burgim. Ndërsa për kërkuesin tjetër, Nasi Hodo, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë vetëm për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje ndaj shtetasve D.K. dhe E.M. Ajo gjykatë ka prishur vendimin e shkallës së parë për pjesën tjetër dhe, duke bashkuar dënimet në një të vetëm, e ka dënuar përfundimisht këtë kërkues me 2 vjet burgim, si dhe ka urdhëruar lirin e menjëhershëm nga paraburgimi.

3. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe trashëgimtarët e viktimës P.B., të cilët kanë kërkuar lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, prishjen e vendimit të apelit, si dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në shkallë të parë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2079 (314), datë 17.12.2024 (*vendimi i Gjykatës së Lartë*), ka vendosur prishjen e vendimit të

apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit të trashëgimtarëve të viktimës së veprës penale, pasi ata nuk njihen si subjekt në fazën e gjykimit në themel të akuzës.

5. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual përkatësisht në datën 7.7.2025 dhe në datën 19.9.2025, sipas objektit të tij. Në datën 4.12.2025, për ankimin e kërkuesit Xhonatan Muçaj, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërkohë, në lidhje me ankimin e kërkuesit Nasi Hodo, Kolegji tjetër i Gjykatës në datën 3.12.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 12.12.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur bashkimin e çështjeve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, pretendojnë se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e:

6.1. *Aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, sepse kërkuesi Xhonatan Muçaj nuk është njoftuar për zhvillimin e procesit ndaj tij në Gjykatën e Lartë, pasi ndodhej i izoluar pranë Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Rrogozhinë, për rrjedhojë i është cenuar e drejta për t'u përfaqësuar nga një avokat mbrojtës, që përfaqësonte mjetin e vetëm për ushtrim efektiv të së drejtës për t'u mbrojtur. Ndërsa kërkuesi Nasi Hodo nuk është njoftuar as për rekursin, as për procesin, duke i mohuar atij mundësinë reale për të ushtruar të drejtën për mbrojtje efektive dhe për t'u dëgjuar.

6.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal ka ripërcaktuar faktet duke ndryshuar dinamikën e ngjarjes të pranuar nga të dyja gjykatat e faktit. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka anashkaluar dhënien e një qëndrimi ligjor për sa i përket anës subjektive të institutit të bashkëpunimit dhe zbatimit të tij në rastin konkret, në kushtet kur



gjykatat e faktit kanë bërë vlerësime të ndryshme për formën e bashkëpunimit.

6.3. *Së drejtës për liri personale*, të mbrojtur nga nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës.

7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë, nuk ka paraqitur parashtrime në kundërshtim të pretendimeve të kërkuësve.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Gjykata çmon se kërkuësi, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt gjykimi kushtetues dhe, për rrjedhojë, kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Po kështu, kërkuësi kanë *shteruar mjetet juridike efektive* që kanë pasur në dispozicion, pasi objekt i kërkesës së tyre është vendimi përfundimtar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë me anë të të cilit ata janë deklaruar fajtorë dhe dënuar.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata konsideron si

pikënisje për llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual momentin kur kërkuësi merr dijeni për arsyetimin e vendimit gjyqësor objekt kërrimi. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim* dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.1.2025, § 13).

12. Në çështjen konkrete, vendimi gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 17.12.2024. Gjykata vëren se në përgjigje të kërkesës së përfaqësuesit ligjor të kërkuësit Xhonatan Muçaj, me shkresën nr. 2972/1 prot, datë 5.6.2025, Drejtoria e Administrimit Gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë ka bërë me dije se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 7.3.2025. Në rastin e kërkuësit Xhonatan Muçaj, kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 7.7.2025 dhe për pasojë kërkuësi legjitimohet *ratione temporis*. Ndërsa kërkesa e kërkuësit Nasi Hodo është paraqitur në Gjykatë më 19.9.2025, në dukje përtej afatit ligjor 4-mujor. Gjykata vëren se kërkuësi ka parashtruar se nuk ka marrë dijeni për rekursin e subjektit të interesuar dhe rrjedhimisht as për procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, pasi ndodhej jashtë shtetit. Ai pretendon se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 20.5.2025, kur, me anë të postës, është njoftuar e ëma e tij për urdhrin nr. 268 datë 2.5.2025, “Për ekzekutimin e vendimit nr. 521 (61-2019-7623) datë 27.12.2019”. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë faktin që në dosjen gjyqësore nuk gjendet një akt njoftimi i rekursit për këtë kërkuësi, jurisprudencën e GJEDNJ-së për detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj dhe faktin se barra e provës në këtë drejtim nuk mund të rëndojë mbi kërkuësit, Gjykata vlerësoi se edhe kërkuësi Nasi Hodo legjitimohet *ratione temporis*.

13. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuësi kanë ngritur disa pretendime për procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë në lidhje me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj* dhe së drejtës së *aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pretendime këto me natyrë kushtetuese, që do të analizohen nga



Gjykata në themel. Kërkuesit kanë ngritur edhe pretendime për cenimin e *lirisë personale*. Duke qenë se këto të fundit janë të ndërruara nga pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon t'i analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

14. Në lidhje me pretendimin për cenim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka dalë jashtë funksionit të tij si gjykatë ligji, pasi Gjykata e Lartë ka ripërcaktuar faktet duke ndryshuar dinamikën e ngjarjes të pranuar nga të dyja gjykatat e faktit. Nëpërmjet versionit të ri të rrethanave, paraqitur ndryshe që në pjesën përshkruuese të vendimit, Kolegji Penal ka dhënë vlerësime të ndryshme nga sa është provuar dhe pranuar nga të dyja gjykatat e faktit, duke marrë në shqyrtim provat e duke tejkaluar kështu funksionin e tij ligjor. Po kështu, Kolegji Penal nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur ligjor për sa i përket anës subjektive të institutit të bashkëpunimit dhe zbatimit të tij në rastin konkret, në kushtet kur gjykatat e faktit kanë bërë vlerësime të ndryshme për formën e bashkëpunimit. Arsyetimet përkatëse të të dyja gjykatave për këtë çështje të ligjit nuk evidentohen në vendimin e Kolegjit Penal.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në kuptimin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është theksuar se në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën

e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim dhe në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimin në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 57, datë 9.11.2023; nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se Gjykata e Lartë nuk mund të bëjë ripërcaktim të fakteve bazuar në një vlerësim të ndryshëm të provave të shqyrtuara dhe të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, por mundet që faktin e përcaktuar nga të njëjtat prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit, ta cilësojë juridikisht ndryshe dhe të zgjidhë vetë çështjen në rast se konstaton zbatim të gabuar të ligjit prej tij (*shih vendimet nr. 7, datë 20.2.2024; nr. 40, datë 14.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në lidhje me formën e bashkëpunimit ndërmjet kërkuesve, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ai (bashkëpunimi) ka konsistuar në aspektin mendor, në drejtim të parashikimit të ngjarjes dhe është zhvilluar në situatën që ka paraprirë ngjarjen. Ndërsa në ardhjen e pasojave kërkuesit kanë veprime si ekzekutorë secili më vete. Në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se në rastin konkret pasoja kriminale, vdekja e të ndjerit P.B., ka ardhur si rrjedhojë vetëm e veprimeve të drejtpërdrejta të kërkuesit Xhonatan Muçaj në kuadër të grindjes së çastit. Kurse pasoja kriminale, plagosja e lehtë e viktimës E.M., ka ardhur si rrjedhojë vetëm e veprimeve të drejtpërdrejta të kërkuesit Nasi Hodo, përsëri në kuadër të grindjes së çastit. Sipas gjykatës së apelit, të pandehurit (kërkuesit) janë përfshirë në mënyrë të pavarur në konfrontim fizik në dy grupe të veçuara, në distancë nga njëri-tjetri, duke mos pasur asnjë komunikim me njëri-tjetrin dhe duke mos ndjekur reciprokisht sjelljet e njëri-tjetrit.



19. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se në vlerësimin e formës së bashkëpunimit gjykata e apelit ka anashkaluar provat e dëshmitë e marra në proces nga deklaratimet e dëshmitarëve, të të pandehurve dhe të dëmtuarve, nga të cilat pohohet se kërkuesi Nasi Hodo ishte konfrontuar më parë, po atë mbrëmje, me viktimën E.M. Ajo gjykatë është shprehur se nga provat e pranuar në proces rezulton se në mjetin e tyre, përpara ngjarjes, kërkuesit kanë pasur mjete të ftohta, duke përfshirë edhe mjet shpues, duke i paraprirë një konfrontim të mundshëm, sjellje kjo që përbën fazën e bashkëpunimit të hershëm ose bashkëpunimit mendor të referuar nga gjykata e shkallës së parë në drejtim të pasojës.

20. Kolegji Penal i asaj gjykate ka vlerësuar se nga gjendja e fakteve që janë pranuar prej gjykatave të shkallëve më të ulëta, rezulton, ashtu siç është arsyetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, se të pandehurit kanë vepruar si ekzekutorë të vetëm ndaj viktimave të tyre, por qëllimi i tyre i përbashkët ka qenë ulja e rezistencës së viktimave me çdo mjet dhe kusht, duke përfshirë këtu edhe përdorimin e mjeteve të afta për të shkaktuar vdekjen, përfundim ky që mbështet edhe në të dhënat e përgjimit ambiental. Ky vlerësim është i ndryshëm nga ai i gjykatës së apelit, sipas të cilit ka pasur një grindje të çastit, ku secili prej personave të përfshirë në ngjarje ka vepruar i diktuar nga situata e momentit, duke kryer veprime të caktuara ndaj kundërshtarëve të tyre, për rrjedhojë, sipas saj, nuk rezulton i vërtetuar me prova bashkëpunimi mes të pandehurve Nasi Hodo dhe Xhonatan Muçaj, pasi nuk ka pasur shprehje vullneti për kryerjen e veprimeve të caktuara. Ky arsyetim nuk është konsideruar i drejtë nga Gjykata e Lartë, për shkak se jurisprudenca penale njih si formë të bashkëpunimit edhe bashkëpunimin e çastit, i cili është një formë e thjeshtë bashkëpunimi, e lindur aty për aty, në kryerje e sipër të veprës, dhe që plotëson gjithë kuadrin për ta konsideruar veprën penale si të kryer në bashkëpunim. Gjithashtu, ajo gjykatë ka marrë në analizë edhe historikun e mosmarrëveshjeve që kanë shërbyer si shkak për pasojën, ku përplasja e fundit kishte ndodhur vetëm disa orë përpara ngjarjes. Përfundimisht, Kolegji i asaj gjykate vlerësoi se duhet prishur vendimi i gjykatës së apelit, duke u lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë.

21. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk rezulton se ka bërë një

ripërcaktim të fakteve, por i është përmbajtur në analizën e vet ligjore të njëjtave fakte të konstatuara prej gjykatave më të ulëta. Duke analizuar faktet e përcaktuara nga gjykatat më të ulëta, në thelb, Kolegji Penal ka vlerësuar nëse ligjërisht mund të kishte bashkëpunim ndërmjet kërkuesve. Referimi që ai Kolegji bën në provat e administruara nga gjykatat më të ulëta është në funksion të dhënies së një vendimi të arsyetuar, të cilat nuk mund të shihen të shkëputura nga provat e vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, por u shërbejnë argumenteve të përdorura në mbështetje të evidentimit të konceptit juridik të bashkëpunimit. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se duke pasur parasysh natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, është i pashmangshëm referimi në provat gjyqësore të përcaktuara nga gjykatat e faktit për të interpretuar ligjin në përputhje me to.

22. Për sa më sipër, në analizë të vendimmarrjes së tij, nuk rezulton që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të ketë ripërcaktuar faktet e çështjes në tejkalim të kompetencave ligjore që i ka njohur ligji. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka ndjekur procedurën ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik, duke ushtruar funksionet e saj në përputhje me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial

23. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, kërkuesi Xhonatan Muçaj ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për t'u mbrojtur për shkak të mosnjoftimit për zhvillimin e procesit penal në ngarkim të tij në atë gjykatë. Ndërsa kërkuesi Nasi Hodo ka pretenduar se, duke mos i njoftuar personalisht rekursin, Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore dhe për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Kërkuesi Nasi Hodo ka pretenduar se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pas lëshimit të urdhrorit të ekzekutimit të vendimit që e dënonte atë me 18 vjet burg. Si pasojë e mohimit të të drejtave procedurale, kërkuesit pretendojnë se u është shkelur edhe e drejta substanciale e lirisë personale, e parashikuar në nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës.



24. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim të drejtë, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substancial, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e mundësive procedurale dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar gjithashtu se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera. Kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 40,*

datë 14.9.2023; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Përkundrejt pretendimeve të kërkuësve dhe standardeve të lartpërmendura Gjykata do të verifikojë nëse kërkuësit janë njoftuar për rekursin e prokurorisë dhe për zhvillimin e procesit gjyqësor në ngarkim të tyre në Gjykatën e Lartë.

29. Në Gjykatën e Lartë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (*neni 436/a i Kodit të Procedurës Penale (KPP)*), për të cilën palët njoftohen për ditën dhe orën e seancës, të paktën 30 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes afishimit në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura ose kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (*neni 436, pika 3, i KPP-së*).

30. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se, sipas të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja ndaj kërkuësve është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 4.2.2021. Pranë gjykatës që kishte dhënë vendimin, e konkretisht pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, në datën 12.8.2020 kanë paraqitur rekurs trashëgimtarët e viktimës P.B. dhe më pas në datën 17.8.2020 edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Rekursi i prokurorisë i është njoftuar të pandehurit Xhonatan Muçaj pranë ambienteve të paraburgimit, nga ana e sekretarisë së Gjykatës së Apelit Vlorë. Ndërsa njoftimi i rekursit në adresën e banimit të të pandehurit Nasi Hodo, e konkretisht në të njëjtën adresë ku i ishte njoftuar më herët vendimi penal i Gjykatës së Apelit Vlorë, ka qenë i pamundur, për shkak të kthimit të njoftimit me shënimin "Larguar jashtë shtetit". Mbështetur në nenin 140, 143, pika 1, shkronja "ç" dhe 414 të KPP-së, sekretaria e Gjykatës së Apelit Vlorë, në kushtet kur i dënuari Nasi Hodo nuk kishte deklaruar adresë tjetër, ka proceduar me njoftimin me afishim të rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Pas këtij veprimi procedural dhe pasi është respektuar afati për depozitim të kundërrekrurseve, sekretaria ka përcjellë dosjen pranë Gjykatës së Lartë për gjykim.

31. Gjykata e Lartë në datën 7.11.2024 ka nxjerrë njoftimin lidhur me planifikimin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në datën 10.12.2024. Njoftimi është afishuar në ambientet



fizike të asaj Gjykate, si dhe në faqen zyrtare të internetit. Po ashtu, konform nenit 436, pika 3, të KPP-së, sekretaria ka njoftuar me mjete elektronike edhe avokatët që kishin mbrojtur të pandehurit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Më pas, çështja është shtyrë për në datën 17.12.2024 dhe në përfundim Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

32. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore, të tërhequr për nevoja të shqyrtimit kushtetues, rezulton se në procesverbalin gjyqësor të datës 10.12.2024, "Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi pa praninë e palëve", theksohet: "Palët ndërgjyqëse në proces kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit, me anë të shpalljes publike të datës 7.11.2024 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, si dhe është vendosur shtyrja e seancës për t'u zhvilluar në dhomën e këshillimit në datën 17.12.2024". Në procesverbalin e seancës së datës 17.12.2024 përsëritet i njëjti konstatim dhe pas relatimit të çështjes, Kolegji Penal ka marrë vendimin nr. 00-2024-2079 (314), datë 17.12.2024.

33. Siç u përmend më sipër, nga aktet e kësaj dosjeje rezulton se në datën 12.10.2020 nga kryesekretaria e Gjykatës së Apelit Vlorë janë lëshuar dy dëftesa komunikimi me nr. 602 akti, me qëllim njoftimin e kërkuësve Xhonatan Muçaj dhe Nasi Hodo për rekursin e paraqitura përkatësisht prej Z.B. dhe N.B. (trashëgimtarët e viktimës P.B.), si dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, kundër vendimit të asaj gjykate. Nga kjo dëftesë rezulton: i. Kërkuesi Xhonatan Muçaj, fillimisht, nuk ka marrë dijeni për rekursin, pasi nuk ndodhej në IEVP-në, Vlorë, por në IEVP-në, Rrogozhinë. Më pas, në datën 21.10.2020, kryesekretaria e po asaj gjykate, me anë të shkresës nr. 602 akti, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të saktësuar vendndodhjen e kërkuësit për komunikimin e dëftesës, si dhe kopjeve të rekurseve bashkëlidhur. Nga kjo dëftesë rezulton se kërkuesi ka marrë dijeni për rekursin në datën 4.11.2020. Në dosje konstatohet gjithashtu se avokati A.Z., i caktuar me deklaram nga kërkuesi në seancat gjyqësore në shkallë të parë dhe në apel, është njoftuar me email për datën 10.12.2024 të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. ii) Sipas njoftimit të parë nga Gjykata e Apelit Vlorë, kërkuesi Nasi Hodo nuk ka

marrë dijeni për rekursin, sepse ndodhej jashtë shtetit. Në këto kushte, në datën 21.10.2020, kryesekretaria e po asaj gjykate, me anë të shkresës nr. 602 regjistri, ka kryer shpalljen publike për efekt komunikimi të rekurseve të kryera nga trashëgimtarët e viktimës P.B. dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Mbi këtë shkresë gjendet shënimi "U afishua më 23.10.2020". Për sa i përket njoftimit për gjykimin e çështjes në datën 10.12.2024 në Gjykatën e Lartë, në dosje rezulton i depozituar edhe një procesverbal "Për kryerjen e njoftimit nëpërmjet thirrjes telefonike" me datën 7.11.2024, rreth 1 muaj para marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 133 të KPP-së. Në bazë të këtij akti rezulton se është njoftuar avokati E.D., me përshkrimin se personi që u njoftua "mori njoftim".

34. Në lidhje me kërkuesin Nasi Hodo, rezulton se në gjykimin në shkallë të parë, në seancën e datës 3.6.2019, ka deklaruar se do të përfaqësohet nga avokati E.D., anëtar i Dhomës së Avokatisë Vlorë, të cilit i ka dhënë tagra për përfaqësimin si në mungesë, ashtu edhe në praninë e tij, duke u legjitimuar nga ajo gjykatë për përfaqësimin në gjykim. Edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, kërkuesi Nasi Hodo është përfaqësuar nga i njëjti avokat, E.D., i konfirmuar edhe në seancën e datës 23.4.2020 të zhvilluar pranë asaj gjykate. I njëjti mbrojtës është njoftuar për gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe ka pasur të gjitha mundësitë të konsultohet me dosjen gjyqësore, aq më tepër kur edhe nga afishimi i çështjes në portalin elektronik të Gjykatës së Lartë rezultonte se rekursuese ishte edhe Prokuroria Pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Për më tepër, Gjykata vëren se i njëjti mbrojtës është autorizuar edhe për paraqitjen e ankimit kushtetues të kërkuësit.

35. Për sa më sipër, përkundrejt verifikimeve të dokumenteve shkresore të gjendura në dosjen gjyqësore në ngarkim të kërkuësve, të cilat vërtetojnë njoftimin e padyshimtë të tyre qoftë për rekursin, qoftë për zhvillimin e seancës në Gjykatën e Lartë në mënyrat dhe format e parashikuara nga KPP-ja, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në aspektin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar. Kjo pasi gjykatat e zakonshme kanë përdorur me diligençën e nevojshme mjetet në dispozicion të tyre, për: 1) njoftimin e rekurseve të paraqitura nga prokuroria



për të pandehurit, siç kërkon shprehimisht neni 414 i KPP-së; 2) njoftimin e të pandehurve dhe avokatëve të tyre për datën e gjykimin në Gjykatën e Lartë, siç parashikon shprehimisht neni 436, paragrafi 3, i KPP-së.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.5.2026.

Shpallur më 15.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkuës Xhonatan Muçaj (*kërkuësi Muçaj*) dhe Nasi Hodo (*kërkuësi Hodo*), me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2079 (314), datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ne, gjyqtarët Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahim, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar.

2. Në lidhje me pretendimin e kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t’u njoftuar, për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, shumica ka mbajtur qëndrimin se ai është i pabazuar. Për këtë, pasi ka evidentuar standardet kushtetuese

për të drejtën e aksesit substancial, mbrojtjen reale dhe efektive në procesin penal, si dhe rëndësinë e së drejtës për t’u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim, shumica ka verifikuar nëse kërkuësit janë njoftuar për rekursin e prokurorisë dhe për zhvillimin e procesit gjyqësor në ngarkim të tyre në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafët 23-28 të vendimit*). Për sa i përket njoftimit të rekursit, shumica ka vlerësuar se rekursi i prokurorisë i është njoftuar kërkuësit Muçaj pranë ambienteve të paraburgimit nga sekretaria e Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërsa për kërkuësin Hodo, për shkak të pamundësisë së njoftimit në adresën e banimit dhe në mungesë të deklaramit prej tij të një adrese tjetër, sekretaria e asaj gjykate, mbështetur në nenet 140, 143, pika 1, shkronja “ç” dhe 414 të KPP-së, ka proceduar me njoftimin me afishim të rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë (*shih paragrafët 30 dhe 33 të vendimit*).

3. Ndërsa për sa i përket njoftimit të datës së shqyrtimit dhe zhvillimit të gjykimin në Gjykatën e Lartë, shumica ka evidentuar rregullat procedurale sipas të cilave, kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, sipas nenit 436/a të KPP-së, ndërsa palët njoftohen për ditën dhe orën e seancës, të paktën 30 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes afishimit në mjediset e Gjykatës së Lartë dhe në faqen e saj të internetit, si dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Mbi këtë bazë, shumica ka vlerësuar se Gjykata e Lartë ka bërë njoftimin për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit përmes afishimit në ambientet e saj dhe publikimit në faqen zyrtare të internetit, si dhe ka njoftuar me mjete elektronike avokatët që kishin mbrojtur kërkuësit në Gjykatën e Apelit Vlorë (*shih paragrafin 31 të vendimit*). Në këtë kuadër, shumica i është referuar edhe procesverbalit për kryerjen e njoftimit nëpërmjet thirrjes telefonike, të mbajtur në bazë të nenit 133 të KPP-së, për njoftimin e mbrojtësit të kërkuësit Hodo (*shih paragrafin 33 të vendimit*). Për më tepër, në veçanti për këtë kërkuës, shumica ka evidentuar se ai është përfaqësuar në gjykimet në shkallë të parë dhe në apel nga i njëjti mbrojtës, i cili është njoftuar për gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe ka pasur mundësi të konsultohet me dosjen gjyqësore, aq më tepër kur



nga afishimi i çështjes në portalin elektronik të Gjykatës së Lartë rezultonte se rekursuese ishte edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Po sipas saj, i njëjti mbrojtës është autorizuar edhe për paraqitjen e ankimit kushtetues të kërkuarit (*shih paragrafin 34 të vendimit*).

4. Përfundimisht, shumica ka çmuar se dokumentet shkresore të gjendura në dosjen gjyqësore vërtetonin njoftimin e padyshimtë të kërkuarve, si për rekursin, ashtu edhe për zhvillimin e seancës në Gjykatën e Lartë, në mënyrat dhe format e parashikuara nga KPP-ja, dhe se gjykatat e zakonshme kishin përdorur me diligjencën e nevojshme mjetet në dispozicion për njoftimin e rekurseve të paraqitura nga prokuroria, si dhe për njoftimin e të pandehurve dhe avokatëve të tyre për datën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

5. Ndryshe nga shumica, në vlerësimin tonë, ky pretendim i kërkuarve është i bazuar për arsyet që do të paraqesim në vijim. Fillimisht, çmojmë të evidentojmë ecurinë e procesit gjyqësor në drejtëm të pjesëmarrjes së kërkuarve, mënyrës së zgjedhur prej tyre për realizimin e së drejtës së mbrojtjes dhe njoftimit të akteve gjatë gjykimit përpara gjykatave të faktit, si dhe, më tej, gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

6. Konkretisht, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, rezulton se hetimet paraprake janë zhvilluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndërsa ndaj kërkuarve, në datën 28.7.2017, është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit “Arresti në burg”. Për realizimin e së drejtës së mbrojtjes, kërkuarët kanë zgjedhur avokatë. Ata, së bashku me mbrojtësit e tyre, kanë marrë pjesë në seancën paraprake, në përfundim të së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës 17.10.2018, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim edhe të kërkuarve, të akuzuar për veprën penale “Vrasja me dashje në rrethana cilësuese”, ndaj dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim, me pasojë vdekjen e një shtetasi dhe e mbetur në tentativë me pasojë plagosjen e lehtë të tre shtetasve, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh”, 25 dhe 22 të KP-së. Në gjykimin e çështjes në themel kërkuarët kanë qenë të pranishëm, së bashku me mbrojtësit e zgjedhur me deklaram para gjykatës, ndërsa, pas kërkesës së njërit prej tyre, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës

7.12.2018, ka vendosur deklaramin e moskompetencës tokësore, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Gjykimi i çështjes në themel ka vijuar përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe është zhvilluar me procedurën e zakonshme. Kërkuarët kanë marrë pjesë në gjykim dhe kanë vijuar të mbrohen me avokatë të zgjedhur me deklaram prej vetë tyre, ndërsa avokatët janë njoftuar për aktet e procesit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit, me vendimin e datës 27.12.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke e deklaruar fajtor kërkuarët Muçaj për veprat penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim në dëm të një shtetasi, “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë në dëm të një shtetasi tjetër, dhe “Plagosja e lehtë me dashje”, në dëm të një shtetasi të tretë, të parashikuara nga nenet 76 e 25, 76, 22 e 25 dhe 89 të KP-së, për të cilat, në bashkim të dënimeve, i ka caktuar një dënim të vetëm me 20 vjet burgim. Po ashtu, për të njëjtat vepra penale është deklaruar fajtor edhe kërkuarët Hodo, me ndryshimin se veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje” e ka kryer në dëm të një shtetasi të katërt, ndërkohë që për këto vepra penale, në bashkim të dënimeve, ndaj tij është caktuar një dënim i vetëm me 18 vjet burgim.

8. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuarët Muçaj, akt i cili, krahas tij, është nënshkruar edhe nga mbrojtësi i zgjedhur gjatë gjykimit të çështjes. Po ashtu, në emër dhe për llogari të kërkuarët Hodo, është paraqitur ankim nga avokati i zgjedhur prej tij gjatë gjykimit. Ankimet e kërkuarve, si dhe ato të paraqitura nga i bashkëpandehuri dhe familjarët e një prej viktimave, u janë njoftuar edhe mbrojtësve të zgjedhur të secilit kërkuar.

9. Në gjykimin e çështjes në apel, i cili është zhvilluar gjatë pandemisë COVID-19, kërkuarët kanë marrë pjesë në disa seanca përmes lidhjeve *online*, por ato nuk janë zhvilluar. Në seancën gjyqësore në të cilën është shqyrtuar çështja, kërkuarët kanë zgjedhur të mos marrin pjesë, ndërsa janë mbrojtur nga avokatët e zgjedhur prej tyre me deklaram, të cilët ishin po ata që i kishin mbrojtur edhe në gjykimin në shkallë të parë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e datës 8.7.2020, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me deklaramin fajtor dhe dënimin e kërkuarve për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, e ka prishur atë për



pjesën që ka deklaruar fajtor kërkuesin Muçaj për veprën penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentativë në dëm të një shtetasi, të parashikuar nga nenet 76, 22 e 25 të KP-së, si dhe atë që ka deklaruar fajtor kërkuesin Hodo për veprën penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 76 e 25 të KP-së, duke vendosur pushimin e çështjes penale për kërkuesit. Po ashtu, është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë për pjesën tjetër, duke u deklaruar fajtor kërkuesi Muçaj për veprën penale “Vrasja me dashje”, në dëm të një shtetasi, të parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe, në bashkim të dënimeve, i është caktuar një dënim i vetëm me 12 vjet burgim. Gjithashtu, është deklaruar fajtor kërkuesi Hodo për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, në dëm të një shtetasi tjetër, të parashikuar nga neni 89 i KP-së dhe, në bashkim të dënimeve, i është caktuar një dënim i vetëm me 2 vjet burgim. Për kërkuesin Hodo, ndërsa kishte vuajtur dënimin e caktuar, është urdhëruar lirimi i menjëhershëm nga paraburgimi.

10. Vendimi i arsyetuar i gjykatës së apelit, në datën 23.12.2020, i është njoftuar personalisht kërkuesit Muçaj, në ambientet e paraburgimit, ndërsa, në datën 18.12.2020, i është njoftuar babait të kërkuesit Hodo në adresën e vendbanimit të këtij të fundit. Vendimi nuk u është njoftuar mbrojtësve të zgjedhur nga kërkuesit gjatë gjykimit të çështjes. Ndërkohë, përpara se vendimi i arsyetuar t'u njoftohej kërkuesve, në datën 17.8.2020 prokurori ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, në datën 12.8.2020 është paraqitur rekurs edhe nga disa familjarë të një prej viktimave të veprave penale, të cilët kanë kërkuar prishjen e të dyja vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente. Aktet e rekurseve të prokurorit dhe të familjarëve të një prej viktimave, në datën 4.11.2020 i janë njoftuar personalisht kërkuesit Muçaj, në ambientet e ekzekutimit të dënimit me burgim. Ato nuk i janë njoftuar mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Nga ana tjetër, nuk është arritur që aktet e rekurseve t'i njoftohen kërkuesit Hodo, ndërsa shërbimi postar ka vendosur shënimin “Jashtë shtetit”. Ato nuk i janë njoftuar as mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Ndërkohë, në datën 23.10.2020 sekretaria gjyqësore e gjykatës së apelit ka afishuar shpallje për njoftimin e rekurseve ndaj

kërkuesit Hodo, njërën pranë ambienteve të saj dhe tjetrën në ambientet e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa një kopje e saj i është dërguar, përmes shërbimit postar, njësisë administrative të vendbanimit të këtij kërkuesi, por pa ndonjë konfirmim për afishimin e saj. Ky njoftim, në përmbajtje, evidentonte vetëm faktin e paraqitjes së rekurseve përkatëse.

11. Në datën 7.11.2024 Gjykata e Lartë ka planifikuar shqyrtimin e çështjes së kërkuesve në dhomën e këshillimit të datës 10.12.2024. Njoftimi për këtë është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe, në të njëjtën datë, i është dërguar në rrugë elektronike avokatit mbrojtës të kërkuesit Muçaj, të zgjedhur prej tij me deklarim gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta. Po në datën 7.11.2024, sipas një procesverbali për kryerjen e njoftimit nëpërmjet thirrjes telefonike, të mbajtur nga nëpunësja gjyqësore, është njoftuar edhe avokati mbrojtës i kërkuesit Hodo, i zgjedhur prej tij me deklarim gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta. Në datën 2.12.2024 familjarët rekursues të një prej viktimave të veprës penale kanë paraqitur parashtrime me shkrim në lidhje me rekursin e tyre. Ndërkohë, në datën e planifikuar, Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar se palët kishin marrë dijeni rregullisht sipas ligjit, ka vendosur shtyrjen e seancës për në datën 17.12.2024. Në këtë datë çështja e kërkuesve është shqyrtuar në dhomën e këshillimit dhe Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në datën 10.3.2025 vendimi i arsyetuar i është njoftuar në rrugë elektronike avokatit mbrojtës të kërkuesit Muçaj, të zgjedhur prej tij gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta.

12. Në datën 7.7.2025, një avokat tjetër, i zgjedhur me prokurë të posaçme nga kërkuesi Muçaj, ka paraqitur kërkesë në Gjykatë, ndërsa në datën 19.9.2025 ka paraqitur kërkesë edhe kërkuesi Hodo, përmes të njëjtit avokat që e kishte mbrojtur përpara gjykatave të faktit, tashmë i pajisur me prokurë të posaçme.

13. Përpara se të ndalemi në rregullat procedurale penale relevante, çmojmë të theksojmë se ato duhet të lexohen në dritën e garancive kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor. Kështu, neni 42 i Kushtetutës garanton të drejtën e kujtdo për një gjykim të drejtë, ndërsa neni 31 i saj përcakton garancitë themelore të të pandehurit në procesin penal, ndër të cilat e drejta për të pasur kohën dhe



lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, si dhe e drejta për t'u mbrojtur vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij. Këto garanci përkojnë edhe me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së, në aspektin e gjykimit të drejtë, barazisë së armëve, kontradiktoritetit dhe së drejtës për mbrojtje efektive.

14. Në këtë kuptim, dispozitat e KPP-së që rregullojnë pozitën procedurale të të pandehurit dhe rolin e mbrojtësit nuk mund të lexohen si rregulla thjesht formale, por si garanci procedurale që konkretizojnë të drejtën për mbrojtje reale dhe efektive. Sipas nenit 6 të KPP-së, i pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit, ndërsa mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjorë. Po kështu, neni 34/a i KPP-së i njeh të pandehurit, ndër të tjera, të drejtën të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur, të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson, të ketë kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, si dhe të njihet me materialet e çështjes. Ndërsa neni 48 i KPP-së njeh të drejtën e të pandehurit për të zgjedhur mbrojtës, neni 50 përcakton se mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit. Në të njëjtën linjë, neni 49 i KPP-së parashikon rastet e mbrojtjes së detyrueshme, ndër të tjera, kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet burgim.

15. Për sa u përket njoftimeve, KPP-ja parashikon rregulla të përgjithshme dhe të posaçme, në varësi të aktit që njoftohet dhe pozitës procedurale të personit të cilit i drejtohet njoftimi. Sipas nenit 132 të KPP-së, njoftimet e akteve bëhen nga ftuesi gjyqësor ose nëpërmjet shërbimit postar, ndërsa dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga sekretaria e gjykatës ka vlerën e njoftimit. Neni 133 i KPP-së rregullon njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike, në raste të ngutshme, duke parashikuar se njoftimi me telefon ose me mjete të tjera teknike mund të përdoret, si rregull, përveç të pandehurit dhe me kusht që të dokumentohet marrja e tij. Për të pandehurin, kodi ka parashikuar rregulla të posaçme, përkatësisht njoftimin në vendin e burgimit, sipas nenit 139 të KPP-së. Pika 4 e kësaj dispozite parashikon se, kur i burgosuri lirohet për shkak të ndryshimit të masës së sigurimit, ai detyrohet të deklarojë ose të zgjedhë banesën, kjo

shënohet në aktin e lirimimit dhe i njoftohet autoritetit procedues, ndërsa, kur njoftimi në banesën e deklaruar ose të zgjedhur nuk mund të bëhet, akti i dorëzohet mbrojtësit. Po ashtu, KPP-ja parashikon njoftimin e të pandehurit në gjendje të lirë, sipas nenit 140, njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet, sipas nenit 141, dhe njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit, sipas nenit 142. Për më tepër, neni 143 i KPP-së parashikon rastet e pavlefshmërisë së njoftimeve, ndër të cilat edhe kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja ose kur nuk janë respektuar format për njoftimin me mjete teknike të veçanta dhe, për këtë shkak, ai që duhej njoftuar nuk ka ardhur në dëgjim të aktit.

16. Në fazën e ankimit/rekursit, neni 414 i KPP-së parashikon se akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin. Po ashtu, neni 435/a i KPP-së i njeh palës kundër së cilës është paraqitur rekurs të drejtën për ta kundërshtuar atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër. Ndërkohë, neni 435 i KPP-së, në rregullimin e paraqitjes së rekursit, parashikon se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësi, ndërsa kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit. Për shqyrtimin në Gjykatën e Lartë, neni 436, pika 3, i KPP-së parashikon njoftimin e palëve për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara, përmes afishimit dhe faqes elektronike zyrtare, si dhe në adresat elektronike të deklaruara ose të njohura. Sipas nenit 436/a të KPP-së, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, ndërsa relacioni i gjyqtarit relator pasqyron, ndër të tjera, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, si dhe prapësimet e paraqitura në kundërrekurs.

17. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, të lexuara në dritën e garancive kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor, rezulton se njoftimi i rekursit nuk është një veprim procedural thjesht formal, por mjeti që i mundëson palës kundër së cilës është ushtruar rekurs të dijë për shkaqet e kundërshtimit dhe të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën për kundërrekurs dhe për parashtrime. Kjo merr rëndësi të veçantë kur rekursi



i prokurorit synon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe rikthimin e dënimeve më të rënda ndaj të pandehurve. Po ashtu, duke pasur parasysh se shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë zhvillohet, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh, njoftimi efektiv i rekursit dhe mundësia reale për të paraqitur kundërrekurs ose parashtrime marrin rëndësi përcaktuese për garantimin e mbrojtjes reale dhe efektive, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

18. Në këtë drejtim, çmujmë të evidentojmë se Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se paraqitja e rekursit nga prokurori mbart mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të dënuarit, ndaj u takon organeve përgjegjëse gjyqësore të ndërmarrin hapat e nevojshëm për njoftimin e tij dhe të mbrojtësit të tij, në mënyrë që të garantohet e drejta e mbrojtjes (*shih vendimet nr. 71, datë 30.11.2016; nr. 35, datë 1.6.2015; nr. 7, datë 19.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Në veçanti, për sa i përket gjykimit në Gjykatën e Lartë, Gjykata është shprehur se, në dallim nga procedurat e gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ai ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore, ndaj është i domosdoshëm garantimi për të pandehurin i një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (*shih vendimet nr. 35, datë 1.6.2015; nr. 5, datë 4.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, për të drejtën e mbrojtjes, Gjykata ka pohuar në vijimësi se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që, në funksion të procesit të drejtë, t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 44, datë 2.4.2026; nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se, veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, i garantuar shprehimisht nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përbëjnë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë merr edhe njoftimi i të pandehurit ose i mbrojtësit të tij ligjor për aktet procedurale që ndikojnë në ushtrimin e mbrojtjes, përfshirë

ankimin, rekursin, si dhe ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes (*shih vendimet nr. 35, datë 1.6.2015; nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 16, datë 8.6.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer rastit konkret dhe duke zbatuar standardet e mësipërme, rezultojnë se rekursi i prokurorit përbënte aktin procedural përcaktues mbi të cilin u vu në lëvizje kontrolli i Gjykatës së Lartë për pjesën e vendimit të gjykatës së apelit që kishte qenë në favor të kërkuarësve. Përmbajtja dhe objekti i këtij rekursi kishin rëndësi të posaçme për pozitën e tyre procedurale dhe penale, pasi prokurori kërkonte prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin kërkuarësit ishin dënuar përkatësisht me 20 dhe 18 vjet burgim. Për rrjedhojë, njoftimi efektiv i këtij rekursi dhe krijimi i mundësisë reale për ta kundërshtuar atë përbënin elemente thelbësore të mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Rasti konkret përfshihej pikërisht në situatën e evidentuar nga jurisprudenca kushtetuese, sipas së cilës, kur rekursi i prokurorit mbart mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të dënuarit, organet gjyqësore duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për njoftimin e tij dhe të mbrojtësit të tij, në mënyrë që të garantohet e drejta e mbrojtjes.

21. Për kërkuarësin Muçaj rezultojnë se aktet e rekurseve i janë njoftuar personalisht në ambientet e ekzekutimit të dënimit me burgim, por nuk i janë njoftuar mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Ky fakt, në vlerësimin tonë, nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga mënyra sesi ishte zhvilluar deri atëherë procesi gjyqësor, ku kërkuarësi kishte zgjedhur të realizonte mbrojtjen me ndihmën e avokatit, i cili kishte vepruar në emër dhe për llogari të tij, kishte nënshkruar aktin e ankimit dhe ishte njoftuar për aktet procedurale të rëndësishme të procesit. Në këtë kontekst, njoftimi personal i rekursit vetëm të pandehurit të burgosur, pa njoftuar mbrojtësin e zgjedhur dhe pa u shoqëruar me ndonjë element që të tregonte se kërkuarësi, në kushtet e burgimit dhe brenda afatit të kufizuar ligjor, kishte mundësi reale të komunikonte me të për të vlerësuar shkaqet e rekursit dhe për të përgatitur kundërshtimet, nuk garantonte në vetvete ushtrimin real të së drejtës për kundërrekurs dhe për parashtrime ndaj rekursit të prokurorit. Kjo vlen aq më tepër kur në atë moment nuk rezultonte që kërkuarësi dhe mbrojtësi i tij të ishin



njohur ende me vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit.

22. Kjo është edhe më e dukshme në fazën e rekursit, ku mbrojtja merr natyrë të theksuar teknike. Vetë neni 435, pika 2, i KPP-së kërkon që akti i rekursit dhe memoriet të nënshkruhen nga mbrojtësi, me pasojë mospranimi. Për rrjedhojë, e drejta për të kundërshtuar rekursin e prokurorit përmes kundërrekursit nuk mund të kuptohet si një mundësi thjesht personale dhe formale e të pandehurit, por si një e drejtë që, për t'u ushtruar efektivisht, kërkon përfshirjen reale të mbrojtësit. Në këtë kuptim, në vlerësimin tonë, në kushtet kur rekursi i prokurorit nuk i ishte njoftuar mbrojtësit të zgjedhur, dijenia personale e kërkuesit Muçaj nuk ishte e mjaftueshme, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën teknike të fazës së rekursit dhe rrethanat konkrete të rastit, për t'i krijuar mbrojtjes mundësi reale për të vlerësuar shkaqet e rekursit, për të përgatitur kundërshtimet dhe për t'i paraqitur ato në formën dhe brenda afatit të parashikuar nga ligji.

23. Po ashtu, edhe rrethana e theksuar nga shumica se avokati i zgjedhur nga kërkuesi Muçaj në gjykimin në shkallët më të ulëta ishte njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk e ndryshon këtë përfundim. Ky njoftim lidhej me planifikimin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, ndërsa nuk zëvendësonte njoftimin e rekursit dhe as nuk i krijonte mbrojtjes të njëjtën pozitë procedurale që do të kishte pasur nëse rekursi do t'i ishte njoftuar në kohën dhe mënyrën e duhur, me qëllim ushtrimin e së drejtës për kundërrekurs.

24. Për kërkuesin Hodo situata paraqitet edhe më problematike. Nga aktet rezulton se rekursi nuk i është njoftuar personalisht, pasi shërbimi postar ka vendosur shënimin "Jashtë shtetit". Megjithatë, pas këtij konstatimi, nuk rezulton të jetë ndjekur procedura e posaçme e parashikuar nga neni 142 i KPP-së për të pandehurin jashtë shtetit dhe as procedura e nenit 141 të KPP-së për të pandehurin që nuk gjendet. Po ashtu, rekursi nuk i është njoftuar as mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndonëse ky mbrojtës kishte përfaqësuar kërkuesin në gjykimet në shkallë të parë dhe në apel. Në këtë drejtim nuk mund të anashkalohet as logjika e nenit 139, pika 4, të KPP-së. Edhe pse kjo dispozitë parashikon rastin kur i burgosuri lirohet për shkak të ndryshimit të masës së sigurimit, ajo evidenton se, kur i pandehuri ka qenë në gjendje burgimi dhe më pas lirohet gjatë procedimit, ligji e lidh vijimësinë e njoftimeve me

deklarimin ose zgjedhjen e banesës dhe, kur njoftimi në këtë banesë nuk mund të bëhet, me dorëzimin e aktit mbrojtësit. Në rastin konkret, megjithëse Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka disponuar shprehimisht për ndryshimin e masës së sigurimit, me vendimin e saj ajo e ka dënuar kërkuesin Hodo me 2 vjet burgim, ka konstatuar se ky dënim ishte vuajtur dhe ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij nga paraburgimi, duke sjellë praktikisht shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në burg". Për rrjedhojë, pamundësia e njoftimit të rekursit në adresën e banimit nuk mund të justifikonte kalimin në njoftim me afishim, pa u ndjekur procedurat përkatëse të KPP-së dhe pa iu dorëzuar akti mbrojtësit të zgjedhur.

25. Në këtë drejtim nuk mund të pranohet se afishimi i shpalljes për njoftimin e rekurseve pranë ambienteve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, si dhe dërgimi i një kopjeje të saj njësisë administrative, pa konfirmim për afishimin përbënin njoftim të vlefshëm dhe efektiv të rekursit për kërkuesin Hodo. KPP-ja nuk parashikon njoftimin e të pandehurit nëpërmjet shpalljes publike si mënyrë autonome njoftimi. Njoftimi nëpërmjet shpalljes publike parashikohet shprehimisht vetëm për viktimat e veprës penale, në kushtet e nenit 138 të KPP-së. Për të pandehurin ligji ka parashikuar rregulla të posaçme, të lidhura me situatën e tij konkrete. Në mungesë të ndjekjes së këtyre procedurave, afishimi i kryer në rastin konkret nuk mund të barazohej me njoftim efektiv të rekursit. Për më tepër, edhe përmbajtja e shpalljes së afishuar nuk rezulton të ketë qenë e tillë që t'i mundësonte këtij kërkuesi të njëjti me shkaqet konkrete të rekursit. Ajo evidentonte vetëm faktin e paraqitjes së rekurseve përkatëse, ndërkohë që e drejta për kundërrekurs, sipas nenit 435/a të KPP-së, presupozon njohjen me përmbajtjen dhe shkaqet e rekursit të palës tjetër. Vetëm dijenia abstrakte se është paraqitur rekurs nuk është e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtje efektive, aq më tepër kur rekursi i prokurorit synonte rikthimin e një dënimi shumë më të rëndë për kërkuesin.

26. Po ashtu, edhe rrethana e evidentuar nga shumica se i njëjti mbrojtës ka përfaqësuar kërkuesin Hodo edhe në ankimin kushtetues individual nuk mund të shërbejë si argument për të vlerësuar të rregullt njoftimin e rekursit në procesin penal. Ky përfaqësim i mëvonshëm nuk provon se mbrojtësi ka marrë dijeni efektive për rekursin e prokurorit në



kohën kur duhej të ushtrohej e drejta për kundërrekurs dhe as nuk mund të rivendosë në mënyrë prapavepruese mundësinë e humbur për ta kundërshtuar atë. Përkundrazi, kjo rrethanë tregon se mbrojtësi ka qenë i identifikueshëm nga aktet e procesit dhe, për këtë arsye, mosnjohimi i tij për rekursin nuk mund të justifikohet me pasiguri për përfaqësimin.

27. Në vlerësimin tonë, njohimi i mëvonshëm i avokatëve të të dy kërkuesve për datën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk mund të mënjanojë mungesën e njohimit efektiv të rekursit të prokurorit dhe pasojat që kjo mungesë kishte sjellë për ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes. Ky njohim lidhet me planifikimin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe nuk rivendoste në afat të drejtën për kundërrekurs. Në momentin kur mbrojtësit u njohuan për datën e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, nuk rezulton që atyre t'u ishte njohur më parë rekursi i prokurorit, në mënyrë që të mund të vlerësonin shkaqet e tij dhe të ushtronin, në kohën dhe formën e kërkuar nga ligji, të drejtën për kundërrekurs ose për parashtrime. Për rrjedhojë, njohimi i datës së seancës, pa një njohim të mëparshëm efektiv të rekursit, nuk ishte i mjaftueshëm për të garantuar kontradiktoritet real në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

28. Po ashtu, nuk mund të konsiderohet vendimtare rrethana se mbrojtësit e kërkuesve kishin mundësi të konsultoheshin me dosjen gjyqësore pas njohimit të datës së shqyrtimit në Gjykatën e Lartë. Në vlerësimin tonë, ndonëse palët dhe mbrojtësit e tyre duhet të tregojnë një kujdes të arsyeshëm për ndjekjen e procesit dhe për t'u njohur me rrethana të rëndësishme të tij, kjo nuk nënkupton shkarkimin e organeve gjyqësore nga përmbushja e detyrimeve procedurale që ligji u ka ngarkuar për njohimin e akteve. Përkundrazi, duke qenë se ligji e lidh ushtrimin e së drejtës për kundërrekurs me njohimin e rekursit të palës tjetër, do të ishte joproporcionale që mungesa e këtij njohimi t'u ngarkojë kërkuesve ose mbrojtësve të tyre, mbi supozimin se këta të fundit, pasi janë njohur për datën e shqyrtimit, duhet të verifikojnë vetë nëse ekzistonte një rekurs i paraqitur kundër interesave të të mbrojturve dhe të kërkonin përmbajtjen e tij. Prandaj, detyrimi procedural për njohimin e rekursit nuk mund të zëvendësohet as me njohimin e mëvonshëm të datës së shqyrtimit, as

me mundësinë teorike të mbrojtësit për t'u njohur me dosjen në një moment të mëvonshëm.

29. Për më tepër, në rastin konkret nuk mund të anashkalohet as koha e gjatë, më shumë se 4 vjet, e kaluar nga paraqitja e rekursit të prokurorit deri në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Ky interval kohor e bënte edhe më të domosdoshme që Gjykata e Lartë të verifikonte nëse kërkuesit dhe mbrojtësit e tyre kishin pasur dijeni efektive për rekursin e prokurorit dhe mundësi reale për ta kundërshtuar atë. Edhe në jurisprudencën e saj, Gjykata ka mbajtur në konsideratë kohën e gjatë të kaluar nga dhënia e vendimit të apelit deri në shqyrtimin e rekursit si rrethanë që rëndon detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm për njohimin efektiv të kërkuesit, në përputhje me dispozitat procedurale penale, duke shmangur një qasje formaliste ndaj njohimeve (*shih vendimin nr. 63, datë 24.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky standard vlen edhe në rastin konkret, ku njohimi i datës së shqyrtimit, pas një kohe të gjatë nga paraqitja e rekursit, nuk mund të zëvendësojë njohimin efektiv të vetë rekursit dhe as mundësinë reale për paraqitjen e kundërrekursit.

30. Në vlerësimin tonë, qasja e shumicës e ka reduktuar kontrollin kushtetues në verifikimin formal të ekzistencës së disa akteve njohimi në dosje, pa vlerësuar nëse këto akte, në rrethanat konkrete, u kanë krijuar kërkuesve mundësi reale për të ushtruar mbrojtjen. Në një proces penal, ku rekursi i prokurorit synonte rikthimin e dënimeve të rënda me burgim, ku mbrojtësit e zgjedhur nuk rezulton të ishin njohur për rekursin, ku shqyrtimi në Gjykatën e Lartë ishte zhvilluar në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve dhe ku ndërmjet paraqitjes së rekursit dhe shqyrtimit të tij kishte kaluar një kohë e gjatë, standardi kushtetues kërkonte që njohimi i rekursit të ishte efektiv, i tillë që të mundësonte përgatitjen dhe paraqitjen e kundërshtimeve nga mbrojtja.

31. Për sa më sipër, në vlerësimin tonë, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njohur, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit ishte i bazuar.

32. Nga ana tjetër, në kushtet kur vlerësuam të bazuar këtë pretendim të kërkuesve, çmuam se nuk



ishte e nevojshme të shpreheshim për bazueshmërinë në themel të pretendimit tjetër të tyre për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky pretendim lidhet me mënyrën e ushtrimit të juridiksionit nga Gjykata e Lartë dhe me kufijtë e kontrollit të saj, çështje të cilat, në vlerësimin tonë, pas shfuqizimit të vendimit të kundërshtuar për shkakun procedural të mësipërm, do të mund të shqyrtoheshin nga ajo gjykatë në rishqyrtimin e çështjes, në një proces që garantonte pjesëmarrjen efektive të mbrojtjes dhe kontradiktoritetin.

33. Në përfundim, duke vlerësuar se në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkuesve u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, mbajtëm qëndrimin për pranimin e kërkesës së kërkuesve, shfuqizimin e vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim sërish në atë gjykatë.

Anëtarë: Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci

VENDIM

Nr. 75, datë 18.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 18.6.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (R) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Razije Hoxholli, përfaqësuar nga avokati Arsen Baltëza, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Stilian Hoxholli, në mungesë.

Murat HOXHOLLI, NË MUNGESË.

Ergi Hoxholli, në mungesë.

Shoqëria "Albsig" sh.a., përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Muharrem Bardhoci.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive Anila Hoxha.

Esmerald Xhafa, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-651, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "P", 134, pika 1, shkronja "I", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Razije Hoxholli (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, shoqërisë "Albsig" sh.a. (*shoqëria e sigurimit*) dhe të Byrosë Shqiptare të Sigurimit (*BSHS*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Stilian Hoxhollit, Murat Hoxhollit, Ergi Hoxhollit dhe Esmerald Xhafës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 6.7.2008 ka ndodhur një aksident automobilistik, si pasojë e të cilit kërkuesja është dëmtuar rëndë. Lidhur me këtë ngjarje, në datën 20.2.2009, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal ndaj shtetasit Esmerald Xhafa, për kryerjen e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, të parashikuar nga neni 290, paragrafi 1, i Kodit Penal (*KP*). Gjatë hetimeve paraprake, organi



procedues ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, i cili, në përfundim të ekzaminimit të kërkuësës, në datën 6.7.2009 ka vlerësuar se dëmtimet e konstatuara hynin në kategorinë e plagosjeve të rënda. Po me vendim të organit procedues, në datën 3.9.2009 është kryer edhe ekspertimi autoteknik për mekanizimin e ngjarjes dhe përcaktimin e përgjegjësive, sipas të cilit shkak i aksidentit, me pasojë dëmtimin e kërkuësës, kishte qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga shtetasi Esmerald Xhafa.

2. Në datën 20.11.2009, çështja penale është dërguar për gjykim dhe në përfundim të shqyrtimit të saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 117, datë 28.2.2011, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit Esmerald Xhafa për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë plagosjen e rëndë të kërkuësës. Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 768, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës.

3. Në datën 11.11.2013 kërkuësja, nëpërmjet avokatit të saj, i është drejtuar shoqërisë së sigurimit me kërkesë për shpërblimin e dëmit, duke referuar, ndër të tjera, edhe kontratën për sigurimin e detyrueshëm të mjetit të drejtuar nga shtetasi Esmerald Xhafa. Në kushtet kur rezultonin paqartësi për shoqërinë sigurore të mjetit, kërkesa i është dërguar për trajtim BSHS-së. Kjo e fundit, pas shqyrtimit të kërkesës, me vendimin nr. 8330 prot., datë 3.10.2014, e ka refuzuar atë, me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afateve ligjore dhe, me shkresën nr. 8611 prot., datë 13.10.2014, i ka kërkuar shoqërisë së sigurimit, si subjekti ku ishte paraqitur fillimisht kërkesa për dëmshpërbim, t’i komunikonte kërkuësës vendimin për refuzimin e saj.

4. Në vijim, në datën 11.9.2014, kërkuësja, bashkëshorti i saj Murat Hoxholli dhe fëmijët e tyre Stilian Hoxholli dhe Ergi Hoxholli i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, si rezultat i dëmtimeve shëndetësore të pësuar nga kërkuësja në aksident. Gjykata e rrethit, me vendimin nr. 6424, datë 19.7.2016 (*vendimi nr. 6424/2016*), ka rrëzuar kërkesëpadinë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se ajo ishte paraqitur tej afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga neni 115, shkronja “dh”, i Kodit Civil (KC).

5. Kërkuësja dhe paditësit e tjerë në atë gjykim, Murat Hoxholli, Stilian Hoxholli dhe Ergi Hoxholli,

kanë paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 6424/2016 të gjykatës së rrethit, pas shqyrtimit të të cilit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1577, datë 15.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, me të njëjtin arsyetim.

6. Kundër këtij vendimi, në datën 17.12.2018, kërkuësja dhe paditësit e tjerë kanë ushtruar rekurs. Ndërsa në datën 13.1.2025, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, kërkuësja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime me shkrim.

7. Për rekursin e kërkuësës dhe të paditësve të tjerë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-651, datë 19.2.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk ekzistonin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat e bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

8. Në datën 21.7.2025, përmes shërbimit postar, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 12.9.2025. Në vijim, në datën 23.10.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën për dorëheqje të një gjyqtari kushtetues. Në datën 28.10.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 10.11.2025 kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata e apelit nuk ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të ngritura në ankim, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit, megjithëse ato përmbushnin kërkesat e nenit 472 të KPC-së në kohën e paraqitjes së tij.

9.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej saj në rekurs për momentin e fillimit të afatit të



parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, konkretisht nëse në rastin konkret ky afat fillonte nga dita kur asaj i kishte lindur e drejta e padisë (nga data 10.5.2012, kur vendimi penal kishte marrë formë të prerë) ose nga dita kur i ishte njoftuar praktika e vlerësimit të dëmit.

9.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi për llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës në vendimin nr. 66, datë 3.11.2024 (*vendimi nr. 66/2024*) për çështje të ngjashme dhe në vendimin njësuës nr. 00-2024-1494, datë 15.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*vendimi njësuës nr. 1494/2024*). Moszbatimi i këtyre vendimeve ka sjellë si pasojë edhe cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*.

9.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar shkaqet e rekursit dhe, në kundërshtim me ligjin material dhe jurisprudencën e saj, i ka vlerësuar si të ligjshme pretendimet e parashtuara nga pala e paditur.

9.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer një vlerësim ligjor për pretendimet e ngritura nga ajo në rekurs, ndërsa vendimi i kësaj gjykate është tërësisht i paarsyetuar dhe i mungon analiza juridiko-ligjore.

10. Subjektet e interesuara, shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja, kanë paraqitur të njëjtat argumente, duke prapësuar në mënyrë të përmblëdhur, se:

10.1. Pretendimi për cenimin *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj ligjore.

10.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi, në rastin konkret, rrethanat e faktit janë të ndryshme nga ato të trajtuara në vendimin nr. 66/2024 të Gjykatës. Që në datën e aksidentit kërkesja dhe paditësit e tjerë e kanë ditur për dëmin e pësuar dhe shkaktuesin e tij, shtetasin Esmerald Xhafa, i cili është proceduar edhe penalisht. Afati ligjor 3-vjeçar i parashkrimit ka filluar në datën 20.11.2009, kur çështja penale është dërguar për gjykim, dhe në datën 11.9.2014, kur është depozituar kërkesëpadia në gjykatën e shkallës së parë, ky afat kishte kaluar.

10.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, është i pabazuar, pasi

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar shkaqet e rekursit të paraqitura nga kërkesja, për të cilin ka vlerësuar se nuk përmbushnin kriteret ligjore.

10.4. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e plotëson këtë standard. Vetëm fakti i mospranimit të rekursit të kërkeses nuk përbën shkak për cenimin e këtij standardi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Po kështu, ajo plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.



13. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se subjektet e interesuara, shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja, kanë parashtruar se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i është njoftuar kërkuases nëpërmjet përfaqësuesit të saj në datën 21.3.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 23.7.2025.

14. Në kundërshtim nga sa subjektet e kundërshtuara pretendojnë, Gjykata eidenton se vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.2.2025 dhe është njoftuar në adresën elektronike të përfaqësuesit të kërkuases në datën 21.3.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar në datën 21.7.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se, pavarësisht se në objektin e kërkesës kërkuësja ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtje ajo ka ngritur pretendime edhe për vendimin e gjykatës së apelit, duke parashtruar se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së aksesit, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, sikundër edhe *parimit të sigurisë juridike dhe parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuara nga nenet 42, 4 dhe 18 të Kushtetutës.

16. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe parimit të barazisë përpara ligjit*, duke parashtruar se, për llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e mbajtur nga Gjykata në vendimin nr. 66/2024 për çështje të ngjashme dhe vendimin njësoes nr. 1494/2024, të Kolegjit Administrativ.

17. Subjektet e interesuara, shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja, kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi në rastin konkret rrethanat e faktit janë të ndryshme nga ato të trajtuara në vendimin nr. 66/2024 të Gjykatës.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti. Vetëm fakti që në një çështje tjetër është arritur në një zgjidhje të ndryshme, nuk mjafton për të provuar cenimin e parimit të barazisë, pasi çdo çështje paraqet veçoritë e saj faktike dhe provuese (*shih vendimet nr. 47, datë 11.6.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Bazuar në këtë standard, Gjykata vëren se, në kundërshtim nga sa kërkuësja pretendon, si vendimi nr. 66/2024 i saj, ashtu edhe vendimi njësoes nr. 1494/2024 janë dhënë në rrethana të tjera faktike, të ndryshme nga rasti konkret. Kështu, në vendimin nr. 66/2024 të Gjykatës çështja penale ishte pushuar 2 herë nga organi i prokurorisë, pasi autori i aksidentit ishte identifikuar dhe shpallur fajtor rreth 7 vjet pas ngjarjes, ndërsa Gjykata e Lartë nuk kishte arsyetuar për palën kundërshtare ndaj së cilës duhej ngritur padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, në kushtet kur përgjatë kësaj periudhe ajo kishte qenë e pamundur të përcaktohej nga prokuroria dhe gjykatat. Ndërsa vendimi njësoes u referohet pasojave ose dëmeve të ardhura nga paligjshmëria e veprimeve ose mosveprimeve të organeve publike dhe akteve administrative të nxjerra prej tyre. Për rrjedhojë, në kushtet kur çështjet kanë të bëjnë me situata faktike e ligjore të ndryshme, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuases për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit janë haptazi të pabazuara.

20. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vë në dukje se, në thelb, ato parashtrohen në kuadër të mosshqyrtimit nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë të thelbit të pretendimeve të saj, konkretisht momentit të fillimit të llogaritjes së afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.

21. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve, të cilat parashtrohen në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si dhe pozicionin e funksionin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë çështjen në vijim në këndvështrim të *së drejtës së aksesit substancial dhe*



standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Konkretisht, Gjykata do të analizojë nëse në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuases për momentin e fillimit të llogaritjes së afatit për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, si dhe nëse ka mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me to.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuësja ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të ngritura në ankim, ndërsa Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekurs për fillimin e afatit të parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Në rastin konkret, ky afat fillonte në datën 10.5.2012, kur vendimi penal kishte marrë formë të prerë.

23. Subjektet e interesuara, shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar shkaqet ligjore në rekurs të paraqitura nga kërkuësja, duke vendosur mospranimin për shkak të mospërmbyshjes së kriterëve ligjore. Vetëm fakti i mospranimit të rekursit të kërkuases nuk përbën shkak për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 10.4.2025; 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 10.3.2026; nr. 44, datë 4.6.2024; nr. 10, datë 7.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, Gjykata në çdo rast nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, në rastin konkret, Gjykata do të verifikojë nëse, në respektim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje pretendimit me natyrë kushtetuese të kërkuases të parashtruar në rekurs për fillimin e llogaritjes së afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor; nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, në përputhje me standardet kushtetuese dhe nëse i ka cenuar kërkuases të drejtën e aksesit.



28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja dhe paditësit e tjerë e kanë vënë në lëvizje procesin gjyqësor për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga aksidenti, duke e ngritur si gjatë gjykimit në shkallë të parë (në kërkesëpadi dhe në aktin procedural “pretendime përfundimtare”), gjatë gjykimit në apel (nëpërmjet ankimit), ashtu edhe në rekurs për pretendimin për fillimin dhe llogaritjen e afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga data 10.5.2012, kur vendimi penal ka marrë formë të prerë.

29. Në interpretim të neneve 115, shkronja “dh”, dhe 120 të KC-së që përcaktojnë afatin 3-vjeçar të kërimit të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, dhe momentin e fillimit të këtij afati, konkretisht fjalisë *“nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar”*, gjykata e rrethit ka vlerësuar se dijenia e kërkuësës për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar nga aksidenti automobilistik i datës 6.7.2008 rezultonte e provuar, pavarësisht se në kushtet kur në këtë aksident ishin përfshirë dy mjete dhe kërkuësja ishte goditur nga automjeti që drejtohej nga tjetër shtetas, marrja dijeni për personin që kishte shkaktuar aksidentin kishte qenë e vështirë vetëm në momentin e ndodhjes së tij. Më konkretisht, dijenia rezultonte e qartë me: i. regjistrimin në datën 20.2.2009 të procedimit penal në ngarkim të shtetasit Esmerald Xhafa; ii. përpilimin e aktit të ekspertimit autoteknik të datës 3.9.2009; iii. dërgimin për gjykim në datën 20.11.2009 të çështjes penale në ngarkim të këtij shtetasi. Në kundërshtim nga sa kërkuësja dhe paditësit e tjerë pretendonin, afati i ngritjes së padisë nuk fillonte nga dita që vendimi penal kishte marrë formë të prerë, pasi ligji i posaçëm në fushën e sigurimit të detyrueshëm nuk e lidhte detyrimisht ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit me përfundimin e çështjes penale, në të cilën përcaktohej fajësia, ndërsa ky ligj dhe KC-ja nuk përcaktonin ndalime për ngritjen e këtyre padive pavarësisht çështjes penale ndaj personit shkaktar të dëmit. Në këtë situatë, sipas gjykatës, parashkrimi i padisë kishte filluar në vitin 2009 dhe afati 3-vjeçar kishte përfunduar në vitin 2012, duke u shuar në këtë mënyrë e drejta e kërkuësës dhe e paditësve të tjerë për kërkimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor (*shih faqet 8-10 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

30. Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke

vlerësuar se padia duhej të rrëzohej si e paraqitur tej afatit ligjor. Sipas gjykatës së apelit, nisja e procesit penal, por edhe përfundimi i hetimit dhe dërgimi i çështjes në gjyq janë rrethana objektive në të cilat kërkuësja, si e dëmtuar nga vepra penale, mund të informohej për personin që u gjet përgjegjës për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor. Kështu, çështja penale ishte regjistruar nga organi i akuzës në datën 20.2.2009 dhe ishte paraqitur për gjykim në datën 20.11.2009, ndërkohë që padia e kërkuësës për kërkimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor ishte depozituar në datën 11.9.2014, pra tej afatit 3-vjeçar të lindjes të së drejtës së padisë. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim nga kërkuësja, sipas të cilit paraqitja e padisë civile kushtëzohej nga vendimi penal i formës së prerë, duke filluar afati i parashkrimit në datën 10.5.2012, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar, me argumentin se fakti që përgjegjësia civile buronte nga shkaktimi i dëmit, pavarësisht se në raste të caktuara mund të konkurronte edhe me përgjegjësinë penale për autorin, nuk varej nga përfundimi i procesit penal, i cili rregullohej nga e drejta penale. Po sipas gjykatës së apelit, nëse ligjvënësi do të kishte dashur të pengonte afatin e parashkrimit të padisë, duke e lidhur fillimin e tij me përfundimin e procesit penal, ose duke penguar ecjen e afatit të filluar nëpërmjet pezullimit, për shkak të zhvillimit të një procesi penal, kjo duhej të ishte parashikuar në KC (*shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

31. Kërkuësja dhe paditësit e tjerë (bashkëshorti dhe fëmijët e tyre) kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit dhe në rekurs kanë ngritur pretendime për fillimin e llogaritjes së paraqitjes së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga dita që vendimi penal kishte marrë formë të prerë. Në vlerësim të vendimarrjes së gjykatës së apelit, duke vënë në dukje se shkaqet e parashtruara nga kërkuësja në rekurs ishin të njëjta me ato të ngritura prej saj në ankim, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Gjykata e Lartë ka konkluduar se gjykatat më të ulëta kishin respektuar normat procedurale dhe se në vendimarrjet e tyre nuk konstatoheshin shkelje që çonin në pavlefshmërinë e procedurës ose të dhënies së vendimit gjyqësor. Po kështu, vendimet nuk ishin në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndërsa pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave



dilte jashtë juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 19 dhe 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Për sa më lart, Gjykata, duke iu referuar arsyetimit të gjykatave të zakonshme, vëren se kërkesja e ka ushtruar të drejtën e saj të paraqitjes së kërkesëpadisë, ku përmes një procesi gjyqësor, në të cilin janë përcaktuar faktet dhe është zbatuar ligji, është arritur në përfundimin se padia e saj ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Gjykata çmon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë vlerësuar drejt dhe mjaftueshëm për momentin kur fillon të llogaritet afati i parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor si rezultat i aksidentit, duke përcaktuar si moment të fillimit të afatit të parashkrimit të padisë momentin kur çështja është paraqitur për gjykim, duke rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuësës për shkak të paraqitjes së saj tej afatit ligjor. Gjykata vlerëson se kërkesja, në cilësinë e të dëmtuarës nga vepra penale, kishte pasur ose duhet të konsiderohet se kishte dijeni për autorin që i ka shkaktuar dëmin ndaj shëndetit, të paktën që nga momenti që çështja është dërguar për gjykim, pra në datën 20.11.2009 dhe, për rrjedhojë, nga ky moment fillon të llogaritet edhe afati i parashkrimit të padisë, e cila duhet të ishte paraqitur deri në datën 19.11.2012. Në këtë linjë arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që kanë konkluduar se paraqitja e padisë së kërkuësës është bërë në tejkalim të afatit të parashkrimit, sepse padia është paraqitur në datën 11.9.2014, pra 1 vit e 9 muaj tej afatit 3- vjeçar të parashkrimit të parashikuar nga neni 115 i KC-së, është i drejtë.

33. Po kështu, Gjykata vlerëson se përgjigjja që kanë dhënë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për pretendimin se paraqitja e padisë civile kushtëzohej nga vendimi penal i formës së prerë, është e plotë dhe e qartë, sepse analizon se konkurrimi i përgjegjësisë penale për autorin, nuk e pengon atë në kërkimin e shpërblimit të dëmit në rrugë civile. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, duke bërë të vetin arsyetimin dhe analizën e tyre, me arsyetim të kufizuar *de plano*, ka vlerësuar se në rekursin e kërkuësës nuk parashtroheshin asnjë nga shkaqet për të cilat ligjvënësi ka parashikuar ushtrimin e kompetencës së saj si gjykatë ligji. Në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe jurisprudencën kushtetuese

në këtë drejtim. Ai përmban të dhënat e palëve, objektin e gjykimit, mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe arsyetimin e përmbledhur të gjykatave më të ulëta, përfshirë, shkaqet dhe argumentet e paraqitura nga kërkuësja në rekurs, ndërsa në pjesën arsyetuese tekstin e plotë të nenit 472 të KPC-së, mbi të cilin Kolegji Civil i kësaj gjykate ka mbështetur vendimmarrjen e tij. Në këtë kontekst, në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë nuk bie në kundërshtim me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë ai shpreh, në thelb, arsyet mbi të cilat Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e rekursit gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit.

34. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.6.2026.

Shpallur më 15.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Sandër Beci, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuësës Razije Hoxholli, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-651, datë 19.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ne, gjyqtarët në



pakicë Sandër Beci dhe Marjana Semini, jemi kundër vendimit të shumicës që ka vendosur për rrëzimin e kërkesës së kërkuës për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, sepse Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje pretendimit me natyrë kushtetuese të kërkuës të parashtruar në rekurs për fillimin e llogaritjes së afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, në vijim parashtrojmë argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në vlerësimin tonë, vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual konkret, ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, të garantuara nga nenet 42 dhe 142 të Kushtetutës.

3. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, si dhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, po ashtu, se në rastet

kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimi të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsytimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 23, datë 25.4.2023; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në analizë të vendimit të Gjykatës së Lartë, vërejmë se, ndërsa në të kanë gjetur pasqyrim pretendimet e ngritura nga kërkuësja në rekurs, nuk rezulton të jenë evidentuar pretendimet dhe argumentet e parashtruara prej saj në parashtresën me shkrim të paraqitur në datën 13.1.2025 (pra përpara seancës gjyqësore), ndonëse ky akt procedural është administruar rregullisht në dosjen gjyqësore. Në parashtresën me shkrim përpara Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kërkuësja ka sjellë në vëmendje të asaj gjykate qëndrimin e mbajtur nga Gjykata në vendimin nr. 66/2024 dhe qëndrimin e mbajtur nga vetë Gjykata e Lartë në vendimin e saj njëses nr. 1494/2024, ku, ndër të tjera, për sa i përket *afatit të paraqitjes së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor shkaktuar nga paligjshmëria e veprimit ose e mosveprimit administrativ*, ka pohuar se vetëm në rastin kur për shkak të rrethanave është absolutisht e pamundur të identifikohet qartësisht organi publik, shkaktar i dëmit dhe për ngjarjen ka filluar një procedim penal që i pamundëson të dëmtuarit të zbulojë vetë në mënyrë të pavarur faktet me rëndësi për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, fillimi dhe llogaritja e afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor kushtëzohet nga përfundimi i çështjeve të mësipërme me vendim gjyqësor të formës së prerë (*shih pikën 3 të paragrafit 91 të vendimit njëses të Gjykatës së Lartë*).

6. Në këtë këndvështrim, ndonëse shumica ka argumentuar se Gjykata e Lartë në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, duke bërë të vetin arsyetimin dhe analizën e tyre, me arsyetim të kufizuar *de plano*, ka vlerësuar se në rekursin e kërkuës nuk parashtroheshin asnjë nga shkaqet për të cilat ligjvënësi ka parashikuar ushtrimin e kompetencës së saj si gjykatë ligji dhe se arsyetimi i saj është në përputhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, mendojmë se duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencë kushtetuese, sipas së cilës të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (në funksion dhe të garancive të të



drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 56, datë 9.11.2023; nr. 6 datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata e Lartë në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të fillimit të llogaritjes së afatit për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor dhe t'u përgjigjej pretendimeve të kërkuësës, duke arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme nëse në rastin konkret: i. barra e provës rëndonte në mënyrë të pavarur mbi vetë të dëmtuarin për të provuar fakte që nuk kanë thjesht natyrë civile, që lidhen me autorin, me veprimin ose me sjelljen që ka shkaktuar dëmin, e cila ngrihet në nivelin e sjelljes me natyrë penale; ii. nëse neni 120 i KC-së e lidh fillimin e afatit të parashkrimit vetëm me momentin kur subjekti merr ose kishte mundësi të merrte dijeni mbi dëmin dhe autorin, ose formimi i dijenisë mbi ekzistencën e pretendimit civil lidhet në mënyrë të detyrueshme dhe kumulative edhe me kushtet e parashikuara nga neni 608 i KC-së për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, të tilla si: ekzistenca e kundërligjshmërisë së sjelljes, e fajit dhe e lidhjes shkakësore midis veprimeve të shkaktuesit të dëmit dhe vetë dëmit; iii. nëse marrëdhënia ndërmjet procedimit penal dhe nenit të 120 i KC-së duhet të analizohet në kuptimin e një varësie formale ndërmjet dy proceseve ose në funksion të ndikimit konkret që procedimi penal ka pasur mbi mundësinë reale të subjektit për të evidentuar dhe për të ushtruar efektivisht kërkimin civil; iv. nëse në rastin e parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit krahas kalimit të afatit ligjor tre vjeçar duhet të konkurrojë edhe humbja e interesit të të dëmtuarit në mënyrë që të mund të interpretohet automatikisht si pasivitet ose braktisje e së drejtës; v. nëse gjente zbatim qëndrimi i parashtruar prej saj në vendimin njësuës nr. 1494/2024 ose vendimin nr. 66/2024 të Gjykatës, i cili është i detyrueshëm për zbatim edhe për vetë Gjykatën e Lartë (pavarësisht se pretendimet për to janë ngritur nga kërkuësja në parashtrësën e saj, për faktin se kur është paraqitur rekursi këto vendime nuk kishin hyrë ende në fuqi).

7. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se kjo analizë do të ishte e nevojshme në përputhje edhe me parimet kushtetuese, jurisprudencën kushtetuese e praktikën njësuëse të Gjykatës së Lartë, si dhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të

procesit gjyqësor, me qëllim që kërkuësja të merrte një përgjigje për sa i takon interpretimit të ligjit material me pasoje në të drejtat substanciale individuale. Ky standard arsyetimi do të ruante ekuilibrin ndërmjet sigurisë juridike dhe mbrojtjes të të drejtave subjektive, duke shmangur si formalizmin mekanik që do të çonte në fillimin e afatit, pavarësisht mungesës së dijenisë së subjektit, ashtu edhe subjektivizimin absolut të momentit të dijenisë. Në këto kushte, në kuadër të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuësës nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo është i paplotë dhe vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e aksesit të lidhur edhe me standardin arsyetimit të vendimit gjyqësor.

8. Në këto kushte, për sa më sipër, nuk pajtohemi me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata në çështjen konkrete për rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkuësës dhe jemi të mendimit se vendimi nr. 00-2025-651, datë 19.2.2025, i Gjykatës së Lartë duhej të ishte shfuqizuar, pasi cenon procesin e rregullt ligjor në aspekt të aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Anëtarë: Sandër Beci, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 80, datë 30.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 30.6.2026
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të



dokumenteve çështjen nr. 17 (P) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Pranvera Dashi, Denis Dashi, përfaqësuar nga avokati Olgert Boxhufi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3664, datë 13.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1833 (67), datë 4.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve Pranvera Dashi (*kërkuësja e parë*) dhe Denis Dashi (*kërkuësi i dytë*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tiranë (*Drejtoria Vendore e Kadastrës*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Familja bujqësore e kërkuësës së parë ka përfituar nga komisioni i ndarjes së tokës në Marqinet, Tiranë sipërfaqen e tokës 122.200 m², të ndarë në pesë parcela, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të shfuqizuar, dhe VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992, “Për rristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar (*VKM-ja për rristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore*). Trashëgimlënësi i saj Shaqir P. (gjyshi) pretendohet se përpara reformës agrare ka dorëzuar tokë bujqësore për krijimin e ndërmarrjeve bujqësore. Për këtë

sipërfaqe toke në vitin 1999 është lëshuar Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*) pa numër dhe pa datë në emër të kërkuësës së parë, e cila e ka regjistruar atë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë. Nga kjo sipërfaqe kërkuësja e parë ka shitur dy parcela me një sipërfaqe totale 7000 m².

2. Mbi kërkesën e një shtetasi që kishte pretendime për mbivendosje të pjesshme të pasurive, Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë (*KVVTP*) ka shqyrtuar vlefshmërinë ligjore të AMTP-së në fjalë. Kërkuësja e parë ka depozituar shpjegime për përfitimin e pasurive nga ish-bashkëpronarët Shaqir P. dhe Shefqet P. dhe në përfundim të procedimit administrativ, KVVTP-ja, me vendimin nr. 2, datë 16.10.2015, ka shfuqizuar plotësisht AMTP-në në emër të kërkuësës së parë, duke kthyer në pronësi të shtetit sipërfaqen prej 115.150 m² dhe duke detyruar atë të paguajë vlerën për dy parcelat e shitura. Këtë vendim KVVTP-ja e ka marrë pasi ka vlerësuar se komisioni i ndarjes së tokës në Marqinet, Tiranë nuk ka respektuar kriteret e përcaktuara në VKM-në për rristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, të ndryshuar, për shkak se, sipas saj, zëri kadastral i tokës ka qenë kullotë dhe jo tokë bujqësore, se pronësia mbi tokën rezultoi deri në vitin 1938 dhe se kërkuësja e parë nuk ka arritur të vërtetojë pronësinë në vitet kur është kryer reforma agrare. Sipas KVVTP-së, provat e paraqitura nga kërkuësja e parë nuk vërtetojnë qenien anëtare të familjes që ka dorëzuar tokë për themelimin e ish-ndërmarrjes bujqësore edhe pse në VKM-në nr. 255, datë 13.4.2010, “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit ose kompensimit të pronës” janë përcaktuar qartësisht dokumentet për këtë qëllim.

3. Në bazë të vendimit të mësipërm, prefekti i qarkut Tiranë ka paditur në gjykatë kërkuësen e parë dhe familjen e saj, përfshirë kërkuësin e dytë (i biri), duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së plotë të AMTP-së në fjalë, kthimin në pronësi të shtetit të sipërfaqes 115.150 m² dhe pagesën e vlerës për sipërfaqen e shitur.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1529 (80-2015-439), datë 24.3.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në rastin konkret gjen zbatim



VKM-ja për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, e ndryshuar, sipas së cilës toka bujqësore u jepet në përdorim punonjësve të ndërmarrjes bujqësore dhe anëtarëve të trungut të familjeve që kanë dorëzuar tokë bujqësore për formimin e ish-kooperativës/ndërmarrjes bujqësore, të cilët banojnë në të njëjtin qytet dhe nuk u jepet më shumë se sipërfaqja që kanë dorëzuar. Në rastin konkret, përkundër asaj që ka arsyetuar KVVTP-ja, ajo gjykatë ka konstatuar se toka që është dorëzuar për krijimin e ish-kooperativës është e zërit kadastral “tokë bujqësore” dhe jo “kullotë”. Po kështu, sipas saj, prona e ish-pronarit Shaqir P. rezulton të jetë sekuestruar në vitin 1946, pra ka qenë në pronësi të tij deri atëherë. Në këto kushte, ajo gjykatë ka vlerësuar se familja bujqësore e kërkueses së parë (mbesë e të ndjerit Shaqir P.) përmbush kriteret për të përfutur tokë bujqësore në cilësinë e punonjësës së ndërmarrjes bujqësore që ka dorëzuar tokë bujqësore për formimin e ish-ndërmarrjes bujqësore në përputhje me parashikimet e VKM-së për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, duke arritur në konkluzionin se AMTP-ja është e vlefshme ligjërisht. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim prefekti i qarkut Tiranë dhe Avokatura e Shtetit.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3664, datë 13.9.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, deklarimin e pavlefshmërisë dhe shfuqizimin e AMTP-së në favor të kërkueses së parë, kthimin në pronësi të shtetit të sipërfaqes prej 115.150 m² dhe për sa i takon sipërfaqes së tjetërsuar nga ajo, detyrimin që të paguajë në favor të shtetit shumën që përfaqëson vlerën e asaj sipërfaqe. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë duhet ta kishte zgjidhur mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet e palëve, pasi, sipas saj, padia gjen mbështetje në nenin 10 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*ligji për vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*). Në vlerësimin e asaj gjykate, vendimmarrja e KVVTP-së është në përputhje me përgjegjësitë e atij organi të përcaktuara në ligjin e zbatueshëm të identifikuar prej saj, sipas të cilit KVVTP-ja drejton veprimtarinë për shqyrtimin e vlefshmërisë së krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nëpërmjet shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, kërkesave, informacioneve, që i paraqiten nga shtetasit dhe

strukturat shtetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me pronësinë mbi tokën bujqësore (nenit 7, pika 2, shkronja “a”). Ajo gjykatë e ka vlerësuar si të gabuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se lëshimi i AMTP-së është i përligjur mbi arsyetimin se kërkuesja e parë është mbesa e të ndjerit Shaqir P., pasi ajo ose anëtarë të trungu të saj familjar nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore dhe as banorë të fshatit Marqinet, ose të kenë pasur cilësinë e dorëzuesit të tokës bujqësore, për t’u trajtuar me tokë bujqësore në përdorim e më pas në pronësi.

6. Ajo gjykatë ka evidentuar se ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë nr. 9702, datë 1.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (procesi i përmbyllur me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2016-3228 (490), datë 4.10.2016) me të paditur shtetasin A.P., i cili ka përfutur tokë me AMTP, me pretendimin se prona është fituar nga ish-pronari Shaqir P. Në atë vendim për pranimin e padisë së prefektit të qarkut Tiranë arsyetohet se edhe nëse do të merrej parasysh fakti që familja e të paditurit A.P. ishte bashkëthemeluese e ish-ndërmarrjes bujqësore siç parashikohet në VKM-në për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, dhe në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore”, kjo e fundit ka pasur në pronësi të saj përpara vitit 1945 vetëm sipërfaqe pylli, e cila në fakt u takonte jo vetëm trashëgimlënësit të të paditurit A.P. por edhe disa personave të tjerë të fisit të tij, duke arritur ajo gjykatë në përfundimin se i padituri A.P. nuk plotësonte asnjë prej kriterëve të përcaktuara në VKM-në për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore dhe në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore”.

7. Në kushtet kur gjykata e apelit e ka konstatuar gjendjen juridike të sipërfaqes 122.200 m² të përfutur në kundërshtim me ligjin, ajo ka vlerësuar të zgjidhë pasojat në përputhje me ligjin e zbatueshëm, duke pranuar kërkimin sipas padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen e kërkuesve dhe me vendimin nr. 00-2025-1833 (67), datë 4.2.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Ajo gjykatë ka sqaruar se pretendimet eventuale mbi pronën nuk rregulloheshin nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, por nga legjislacioni përkatës për



kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Gjithashtu, ajo gjykatë e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkuësve se Gjykata Administrative e Apelit ka gabuar duke u mbështetur në një vendim gjyqësor për një person që nuk është trashëgimtar i Shaqir P., pasi vendimi, edhe pse nuk është unifikues/njësues, ka lidhje me rastin në gjykim, për arsyen se prona në objekt, në origjinë, i përkiste ish-bashkëpronarit tjetër, Shefqet P.

9. Në datën 18.9.2025 kërkuësit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 30.9.2025. Në datën 5.12.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

10. Në datën 23.6.2026 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se kishte qenë në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 29.6.2026, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

11.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, pasi gjatë seancës gjyqësore të datës 4.2.2025, në Gjykatën e Lartë kërkuësit kanë pretenduar zbatimin e ligjit me fuqi prapavepruese nr. 20/2020, datë 5.3.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (*ligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë*), si një ligj i nxjerrë pas daljes së vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se është i zbatueshëm në çështjet që janë për shqyrtim përpara gjykatave. Edhe pse kjo çështje i është nënshtruar debatit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk e ka përmendur dhe nuk ka arsyetuar sesi gjejnë zbatim normat me fuqi prapavepruese në rastin në

shqyrtim. Në të njëjtën kohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shtruar për njësim çështjen sesi gjen zbatim neni 68, pikat 4, 5 e vijuese të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë për çështjet e regjistruara për shqyrtim pranë gjykatave administrative dhe ka marrë vendimin njësoj vetëm 8 ditë pas vendimit të kërkuësve. Gjykata e Lartë duhet të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, me qëllim që kërkuësit të merrnin një përgjigje për zbatueshmërinë e atij ligji në çështjen e tyre. Ky veprim ka vënë në dyshim edhe të drejtën e kërkuësve për t’u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tyre.

11.1.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi pas seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë kërkuësit janë vënë në dijeni për ekzistencën e një vendimi gjyqësor të marrë nga relatorja A.A. kur ajo ushtronte funksionin e gjyqtarës në gjykatën e shkallës së parë. Në atë vendim palë paditëse ishte prefektura e qarkut Tiranë dhe i paditur shtetasi L.P. me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së plotë dhe shfuqizimin e AMTP-së në pronësi të E.P. Në arsyetimin e atij vendimi kjo gjyqtare ka arsyetuar se në emër të këtij ish-pronari janë marrë me AMTP sipërfaqe të mëdha toke nga 4 familje, përfshirë kërkuësen e parë, duke arritur në përfundimin se titulli i pronësisë së E.P.-së është krijuar në kundërshtim me dispozitat e VKM-së për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore. Pra, gjyqtarja jo vetëm është shprehur mbi një anëtar të fisit Preza, por është shprehur në mënyrë të tërthortë edhe për trashëgimtarët e tjerë, përfshirë kërkuësen e parë. Me vendimin e kundërshtuar, kjo gjyqtare, tashmë në funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Lartë, ka cenuar parimin e paanësisë pasi ka shprehur më parë mendimin dhe ka dhënë vendimin për themelin e kësaj çështjeje, mbi të njëjtat prova thelbësore në gjykim.

11.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi gjykata e apelit duhet të siguronte shqyrtimin në kontradiktoritet të vendimit gjyqësor të formës së prerë të referuar prej saj, të cilin ajo gjykatë e ka vendosur në themel të arsyetimit dhe të vendimmarrjes, për më tepër në kushtet që e ka rrëzuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka ngatërruar pronësinë e gjyshit të kërkuësës së parë, që ka shërbyer si bazë për AMTP-në në fjalë, me pronësinë mbi një tokë që ai e kishte në



bashkëpronësi me bashkëthemeluesin Shaqir P. Në këtë drejtim, vendimi i referuar nga gjykata e apelit është marrë mbi bazën e dokumenteve të pronësisë së vëllazërisë Preza, që është një dokument pronësor tërësisht i ndryshëm nga ai në objekt. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve vetëm mbi bazën e provave dhe të fakteve të paraqitura nga njëra palë, ose nga gjykata kryesisht, e ka bërë procesin të cenueshëm, pasi kërkuesit janë vendosur në pamundësi për t'u mbrojtur efektivisht. Gjykatat duhet të orientonin kërkuesit si palë paditëse të krijonin ndër gjyqësinë e duhur me shtetasin që nisi procedimin administrativ, i cili ka pretenduar mbivendosje titujsh pronësie. Po kështu, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar një dokument thelbësor në gjykim siç është vërtetimi i pronësisë lëshuar nga regjistri i pasurive të paluajtshme për pronësinë vetëm të subjektit të shpronësuar Shaqir P.

11.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi ligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë parashikon se AMTP-të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme edhe nëse përfituesi i tyre nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfituar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij ose trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës, ose ish-ndërmarrjes bujqësore. Edhe VKM-ja nr. 1174/2020, e dalë për zbatim të këtij ligji, përcakton se përfituesi i AMTP-së legjitimohet nëse është trashëgimtar ligjor i personit, toka e të cilit është marrë gjatë reformës agrare për krijimin e ish-kooperativave bujqësore dhe të ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht vendbanimit të tyre në kohën e lëshimit të AMTP-së. Sipas kësaj VKM-je, në rast se dokumentacioni kadastral nuk ekziston, personi legjitimohet si përfitues sipas këtij parashikimi nëse disponon AMTP dhe se në asnjë rast Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) nuk shqyrton vlefshmërinë e dokumentacionit që shërben për legjitimim sipas këtij parashikimi. Ndërkohë, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk e njohin si përfituese të trajtimit me tokë pa shpërblim këtë kategori duke i hyrë vlerësimit të provave nëse trashëgimtarët kanë qenë ose jo banorë të fshatit, duke i vendosur si elemente thelbësore për të mbështetur vendimet përkatëse. Në këtë kuptim, kërkuesit që e posedojnë pronën e trashëgimlënësve të tyre sipas një titulli të ndryshëm nga vendimet e komisioneve të kthimit dhe të kompensimit të pronave nuk duhet të diskriminohen, pasi kjo kategori e ka përfituar tokën

me akt shtetëror si pasojë e një titulli të mëparshëm, të cenuar nga shteti. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm në rastin e kërkuesve përbën trajtim të ndryshëm të palëve në roset me njëra-tjetrën, trajtim që passjell zgjidhje të ndryshme të rasteve analoge.

12. *Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore e Kadastrës*, ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

13. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të legjitimitit dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae*, *shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezultojnë të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit) si dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike. Për këtë të fundit, Gjykata vëren se argumentet në mbështetje të tij lidhen me faktin se gjykata e apelit, vendimi i së cilës është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, ka shfuqizuar AMTP-në në



favor të kërkuësës së parë, duke kthyer tokën në pronësi të shtetit në shkelje të parashikimeve ligjore në fuqi. Për këtë arsye, Gjykata çmon që këtë pretendim ta analizojë në drejtim të procesit të rregull ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, me pasojë në parimin e sigurisë juridike, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

16. Kërkuësit kanë pretenduar se gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë ata kanë diskutuar për zbatimin e dispozitave kalimtare të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, me arsyetimin se ka fuqi prapavepruese në çështjet që janë për shqyrtim përpara gjykatave. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë nuk e ka përmendur këtë çështje në vendimin e saj. Në të njëjtën kohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shtruar për njësim çështjen sesi gjen zbatim neni 68, pikat 4, 5 e vijuese të atij ligji për çështjet e regjistruara për shqyrtim pranë gjykatave administrative dhe ka marrë vendimin njësuës vetëm disa ditë pas vendimit të kërkuësve. Gjykata e Lartë si gjykatë ligji duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, me qëllim që kërkuësit të merrnin një përgjigje për zbatueshmërinë e atij ligji në çështjen e tyre. Ligji në fjalë parashikon se AMTP-të e paregjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk i nënshtrohen verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK-ja nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në të. Sipas VKM-së së dalë për zbatim të këtij ligji, në rast se dokumentacioni kadastral nuk ekziston, personi legjitimohet si përfitues sipas këtij parashikimi nëse disponon aktin e marrjes së tokës në pronësi dhe se në asnjë rast ASHK-ja nuk shqyrton vlefshmërinë e dokumentacionit që shërben për legjitimim sipas këtij parashikimi, ndërkohë gjykatat në rastin e kërkuësës nuk e njohin si përfituese këtë kategori, por i hyjnë vlerësimit të provave nëse trashëgimtarët kanë qenë ose jo banorë të fshatit, duke i vendosur si elemente thelbësore për të mbështetur vendimet përkatëse. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm në rastin e kërkuësve përbën trajtim të ndryshëm të palëve në roset me njëra-tjetrën, trajtim që passjell zgjidhje të ndryshme të rasteve analoge.

17. Lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata është shprehur se ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë e publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 21, datë 16.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohej arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 35, datë 25.7.2011; nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 79, datë 14.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e



gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 45, datë 23.7.2012; nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka pohuar se në kushtet kur ka një vendim unifikues ose njëses të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural për një çështje të caktuar, ky fakt sjell pritshmëri për individin se ligji do të zbatohet dhe do të interpretohet në mënyrë uniforme, siç është njësuar me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë për të njëjtën çështje ligjore (*shih vendimin nr. 47, datë 11.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, Gjykata do të verifikojë nëse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, është shprehur për ligjin e zbatueshëm në çështjen e kërkuarësve, si dhe nëse ka marrë në konsideratë faktin se Kolegji Administrativ i saj kishte shtruar për njësim çështjen ligjore që ishte edhe objekt i procesit të kërkuarësve, pra nëse ata kanë marrë përgjigje për zbatueshmërinë e ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në çështjen e tyre.

22. Sikurse u parashtrua më sipër, kërkuarësit kanë përfutur nëpërmjet AMTP-së së vitit 1999 tokë pa pagesë për shkak të pretendimit se përpara reformës agrare gjyshi i kërkuarës së parë ka dorëzuar tokë bujqësore për krijimin e ndërmarrjeve bujqësore. Kjo AMTP është shfuqizuar nga KVVTP-ja, me arsyetimin se nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara në VKM-në për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, të ndryshuar, për shkak se zëri kadastral i tokës ka qenë kullotë dhe jo tokë bujqësore dhe se pronësia mbi të rezulton deri në vitin 1938 (përpara reformës agrare) dhe se kërkuarësja e parë nuk ka arritur të vërtetojë pronësinë në vitet kur është kryer reforma agrare.

23. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë së prefektit të qarkut Tiranë për deklarimin e pavlefshmërisë së plotë të AMTP-së, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret gjen zbatim VKM-ja për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore, e ndryshuar, dhe se, për rrjedhojë, familja bujqësore e kërkuarës së parë (mbesë e të ndjerit

Shaqir P.) përmbush kriteret e përcaktuara në të për të përfutur tokë bujqësore. Ajo gjykatë ka konstatuar se toka që është dorëzuar për krijimin e ish-kooperativës është e zërit kadastral “tokë bujqësore” dhe jo “kullotë”, si dhe prona e ish-pronarit Shaqir P. është sekuestruar në vitin 1946.

24. Në të kundërt, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka identifikuar drejt ligjin e zbatueshëm, që, sipas saj, është ligji për vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Sipas asaj gjykate, i gabuar është edhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se lëshimi i AMTP-së është i përligjur, pasi kërkuarësja e parë ose anëtarë të trungut të saj familjar nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore dhe as banorë të fshatit Marqinet. dhe as kanë pasur cilësinë e dorëzuesit të tokës bujqësore, për t'u trajtuar me tokë bujqësore në përdorim e më pas në pronësi, duke vlerësuar se toka është marrë prej kërkuarësve në kundërshtim me ligjin. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se edhe pretendimet eventuale mbi pronën nuk rregulloheshin nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, por nga legjislacioni përkatës për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve.

25. Lidhur me AMTP-të dhe verifikimin e titujve, Gjykata evidenton se ligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë është miratuar në datën 5.3.2020, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 22.4.2020, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit. Në dispozitat kalimtare të tij parashikohet se paditë e ngritura nga prefektët përpara hyrjes në fuqi të atij ligji, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, shqyrtohen nga gjykatat sipas kriterëve të atij ligji dhe se ASHK-ja (si pasardhëse ligjore e prefektit) heq dorë nga padia në të gjitha gjykimet në proces përpara hyrjes në fuqi të ligjit, përveç rasteve kur shkak ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1, të atij ligji (neni 68, pikat 4 dhe 5). Ndërsa neni 7, pika 1 i ligjit parashikon se AMTP-ja e përfutur përpara hyrjes në fuqi të atij ligji, e paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK-ja. Ajo regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme nëse plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) përfutuesi i AMTP-së ka qenë i legjitimuar për të përfutur tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe



nëse nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfituar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij ose trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativeve ose ish-ndërmarrjes bujqësore; b) përfituesi i AMTP-së ka marrë tokë në territorin e vetëm një ish-kooperative ose ish-ndërmarrjeje bujqësore; c) toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë “truall”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohën e lëshimit të aktit.

26. Po në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm, datë 23.7.2024, gjatë shqyrtimit të një çështjeje të ngjashme me atë të kërkuësve, ka shtruar për njësim çështjen *“Si gjen zbatim neni 68, pikat 4, 5 e në vijim i kësaj dispozite kalimtare të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” për çështjet e regjistruara për shqyrtim pranë gjykatave administrative”*. Në datën 18.2.2025, pak ditë pas vendimmarrjes për kërkuësit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë vendimin nr. 00-2025-4083 (79), në të cilin ka arritur në këtë rregull njëses: *“i) në zbatim të nenit 68, pika 5, të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-së, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë, përveç rasteve kur shkaku ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1, të këtij ligji; ii. kur mungon vullneti i shprehur për heqjen dorë nga e drejta e padisë prej ASHK-së, në zbatim të nenit 68, pika 4, të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë gjykatat vijojnë shqyrtimin e padive të ngritura nga prefektët, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-së, sipas kriterëve të këtij ligji; iii. në rast se në padi ngrihen formalisht pretendime me shkaqe nga ato të përcaktuara nga neni 7, pika 1, të ligjit, gjykatat disponojnë për pranimin ose rrëzimin e padisë, varësisht gjendjes së faktit të vërtetuar. Nëse padia nuk ngre formalisht asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 7, pika 1, të ligjit nr. 20/2020, gjykatat vlerësojnë mungesën e legjitimitit aktiv material të palës paditëse dhe disponojnë me rrëzimin e padisë”*.

27. Nga sa më lart, Gjykata vëren se kërkuësit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë në vitin 2017. Në kohën që çështja ka qenë në pritje për t'u shqyrtuar në atë gjykatë, është miratuar ligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, i cili ka parashikuar se paditë e ngritura nga prefektët përpara hyrjes në fuqi të atij ligji, me objekt

pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, siç është dhe rasti i kërkuësve, shqyrtohen nga gjykatat sipas kriterëve të atij ligji dhe se ASHK-ja (si pasardhëse ligjore e prefektit) *heq dorë nga padia në të gjitha gjykimet në proces përpara hyrjes në fuqi të ligjit*, përveç rasteve kur shkaku ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1, të atij ligji. Në datën 4.2.2025 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuësve që kundërshtonte vendimin e gjykatës së apelit që, duke pranuar kërkesëpadinë e prefektit, kishte shfuqizuar AMTP-në në emër të kërkuësës së parë. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, kishte detyrimin të verifikonte dhe të shprehej në mënyrë të arsyetuar nëse ligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë ishte i zbatueshëm në çështjen konkrete të kërkuësve. Ky detyrim buronte jo vetëm nga fakti se ligji kishte hyrë në fuqi gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në atë gjykatë dhe përmbante dispozita kalimtare që shtriheshin edhe mbi proceset në vijim, por edhe nga fakti se vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kishte shtruar për njësim pikërisht çështjen juridike që lidhej me interpretimin dhe zbatimin e këtyre dispozitave. Në këto rrethana, mosmarrja në konsideratë e këtij ligji dhe mungesa e çdo arsyeimi në lidhje me zbatueshmërinë e tij në çështjen konkrete, pavarësisht se kërkuësit e kishin ngritur këtë çështje gjatë seancës gjyqësore të datës 4.2.2025 në parashtrimet e tyre, nuk përbën thjesht një çështje të interpretimit të ligjit material, e cila, si rregull, mbetet jashtë juridiksionit kushtetues. Ajo përbën një gabim ligjor, pra një mungesë arsyeimi për një çështje thelbësore dhe potencialisht përcaktuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

29. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se verifikimi nga ana e Gjykatës së Lartë i heqjes dorë nga prefekti për këto çështje, merr rëndësi nga pikëpamja kushtetuese për individin, pasi *prima facie* lidhet me të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Nga ky këndvështrim, një qasje e tillë e Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin kushtetues të arsyeimit të vendimit gjyqësor dhe nuk u jep kërkuësve një përgjigje gjyqësore efektive për një pretendim me rëndësi vendimtare për çështjen e tyre.



30. Po kështu, Gjykata vëren se, ndonëse çështja juridike ishte shtruar për njësim përpara se të vendosej rekursi i kërkuësve, Gjykata e Lartë vendosi çështjen pa pritur përcaktimin e rregullit njësuës, i cili u miratua vetëm 14 ditë më pas. Në kushtet kur vendimi njësuës kishte për objekt pikërisht interpretimin e dispozitave kalimtare që ishin të zbatueshme në procese si ai i kërkuësve, kjo mënyrë procedimi e Gjykatës së Lartë duket se ka cenuar edhe pritshmëritë e ligjshme të tyre që çështja të shqyrtohej mbi bazën e një interpretimi të njëjtë dhe uniform të ligjit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, me pasoja edhe mbi parimin e sigurisë juridike, është i bazuar.

31. Në kushtet kur, për arsyt e mësipërme, çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata çmon të mos ndalet në analizimin e mëtejshëm të pretendimeve të tjera të kërkuësve. Vlerësimi i mëtejshëm i këtyre pretendimeve i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë, e cila duhet të mbajë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar për to.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuësve duhet të pranohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577,

datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1833 (67), datë 4.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.6.2026.

Shpallur më 15.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 3180, datë 11.6.2026, vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Mark Pemat, me atësi Zef dhe me amësi Lenë, i lindur më 13.4.1922, në Iballë, Pukë si dhe caktimin e shtetases Lena Pemat, si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shtetasit Mark Pemat.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 320 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 155|Datë: 21.07.2026 14:06:47
+02:00|1580f94f-20a0-40f1-b818-37d24793069c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)